

Dëlirje & Edukim

01 qershor 2009 / 8 xhumadell uhra 1430 / Nr. 2 / Çmimi 1 C

REVISTË MUJORE FETARE EDUKATIVE KULTURORE SHKENCORE

- Besimi
- Pejgamberi ynë dhe shokët e tij
- Komentime nga Kur'ani
- Hadith
- Jurisprudencë
- Dëlirje & Edukim
- Familja
- Minberi
- Pyetje dhe përgjigje
- Kolosët e Umetit
- Tema

Ata braktisën familjet, prindërit, vendin e tyre dhe si kompensim të vetmin kishin Islamin, duke i udhëzuar një-riedit e humber, duke i ruajtur ato nga erresura e injorancës dhe e shfrenimit në dritën e Kur'anit dhe të besimit, duke mbartur me vetë dhe duke transmetuar amanetin dhe trashëgiminë e të Derguarit sal-Allahnë dhe të jetës në lindje dhe perëndim.

fq. 7

Çfarë dini për pozitën e mjekrës në Fe?

"Edhe çështja e mjekrës është një obligim fetar, për mbajtjen e së cilës besimtarit i nevojitet bindja për ta praktikuar atë. Me këtë dua të përgënjeshtroj pretendimet e hedhura në mediumet e shtypura në veçanti dhe në mediumet në përgjithësi, se kinsë të rinjtë që kanë filluar të paraqiten te ne me mjekra paguhen me të holla! Kotësinë e këtij pretendimi e kupton çdo analfabet e lere më një intelektual, pasi me të holla mund të mashtrohet një numër shumë i vogël individësh, edhe pse kjo është shumë absurde dhe naive, por është e pamundur të paguhen gjithë këta të rinj që shohim me mjekra, pasi do të nevojitet budheti i ndonjë shteti të fuqishëm ekonomikisht!"

fq. 43

Këshilla e muajit

"A u garantuat ju prej Atij që është në qiell, që të mos lëshojë kundër jush ndonjë stuhi me rebesht gurësh. E pra, da ta kuptoni sa i frikshëm është ndëshkimi im!"

fq. 27



Kryeredaktor:
Zejd Haziri

Anëtarët e revistës:
Unejs Murati
Fidan Xhelili
Xheladin Leka

Bashkëpunëtorët:
Muhamed Abdullahi
Sabahudin Selimi
Bali Sadiku

Redaktor gjuhësor:
Arian Koçi

Redaktor Teknik:
Avni G Gashi

Ballina/Dizajni:
Avni G Gashi

Boton:
Shtëpia botuese
El Atik
Gjilan, Republika e Kosovës

Tirazhi: 1000

Adresa:
Rr. M. Idrizi p.n 60000 Gjilan
Republika e Kosovës
Tel: 044 988 400
e-mail:
delirjedheedukim@gmail.com

PËRMBAJTJA

EDITORIALI	2
Kërkimi i udhëzimit në të vërtetën	2
BESIMI	3
Besimi i Muslimanit Sunij (2)	3
Emërtimi i ehlu Sunnetit	4
PEJGAMBERI YNË DHE SHOKËT E TIJ	7
Shokët e Pejgamberit tonë dhe vlerat e tyre	7
Kush është Pejgambëri yt (2)	10
KOMENTIME NGA KUR'ANI	13
Vlera e dy vargjeve të fundit të kaptinës Bekare	13
HADITH	16
Vargu i gjurmëve autentike nga Sahabët dhe Tabiinët (2)	16
JURISPRUDENCË	19
Fekondimi artificial (Fëmijët e epruvetave)	19
DËLIRJE & EDUKIM	22
Ashtu si je me robërit e Allahut, ashtu Allahu është me ty	22
Cilësitë e thirrësit musliman	24
FAMILJA	27
Sistemi familjar në Islam (2)	27
MINBERI	32
Mënyra e trajtimit të risive në Fe - Bidatet	32
PYETJE & PËRGJIGJE	36
Ndarja e fesë në (lëvore) dhe (bërthamë) është prej "risive në Fe" të sekteve	36
KOLOSËT E UMETIT	41
AbdulAziz Ibën Bazi, Jeta dhe vepra e tij	41
TEMA	43
Çfarë dini për pozitën e mjekrës në Fe?	43

KËRKIMI I UDHËZIMIT NË TË VËRTETËN

Falënderimi i takon Allahut. Atë e falënderojmë dhe prej Tij ndihmë dhe falje kërkojmë. Kërkojmë mbrojtje nga Allahu prej të këqijave të vetvetes dhe të veprave tona. Kë e udhëzon Allahu, s'ka kush e devijon dhe kë e largon nga rruga e vërtetë, s'ka kush e udhëzon. Dëshmoj se s'ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut, i Cili është Një, dhe dëshmoj se Muhamedi është rob dhe i Dërguari i Tij.

Njeriu nga natyrshmëria e tij gjithmonë është kërkues i më të mirës, hulumton për të, përpriqet dhe sakrifikon për të, mirëpo në shumicën e rasteve kjo ka të bëjë me leverditë e tij materiale, kurse sa i përket anës shpirtërore, udhëzimit në fe, njohjes së të vërtetës universale, është shumë neglizhent dhe anashkalues dhe për këtë e ndihmon edhe armiku i tij i përbetuar, shejtani i mallkuar. Ai ia paraqet njeriut praktikimin e ligjeve të Allahut si të vështira e të zorshme, ndërsa arrijtjen e botës materiale ia zbukuron dhe ia bën të lehtë. Pejgamberi ynë na ka lajmëruar për këtë duke na treguar se xheneti është i rrethuar nga vështirësitë dhe sfidat, kurse xhehenemi nga epshet dhe kënaqësitë.

Për dikë kjo është njëra prej arsyeve për të mos i përvjelë krahët në kërkimin e udhëzimit në të vërtetën, mirëpo njeriu harron se jo vetëm në praktikimin e fesë, por edhe në çështjet e dynjasë, nëse nuk ia lehtëson i Madhërishti Allah, atij nuk i lehtësohet. Pra, çdo gjë është në dorë të Allahut dhe këtë e ka transmetuar edhe dijetarja e madhe e këtij umeti, transmetuesja e drejtpërdrejtë nga Pejgamberi ynë dhe njëkohësisht nëna e besimtarëve, Aishja, Allahu qoftë i kënaqur me të, e cila thotë: "Ndihmohuni me Allahun qoftë edhe në një lidhëse të këpucëve (kur ju mungon), sepse nëse Ai nuk ua lehtëson (posedimin e saj), pa dyshim që nuk gjendet."

Me këtë desha t'ju them se njeriu sado i mençur

të jetë, kjo nuk i bën dobi në njohjen e së vërtetës dhe në praktikimin e saj nëse nuk i lehtësohet nga Allahu, udhëzuesi në të vërtetën.

E, ky është një parim i besimit tonë, që duhet të jetë i pranishëm në zemrën e çdo besimtari, përkundrazi, mosprania e tij e bën njeriun qyqar, siç ka thënë edhe Pejgamberi ynë: "Kërko ndihmë prej Allahut (për çdo gjë), e mos u bëj qyqar (i paaftë)."

Prandaj, udhëzimi në të vërtetën duhet të kërkohet, të hulumtohet, të harxhohet kohë pas saj duke ndenjur me hoxhallarë të shkolluar që janë ekspertë në çështje të shariatit dhe të besimit. Feja e vërtetë burimore duhet mësuar nga hoxhallarët e zgjedhur e jo nga çdo pretendues i devijuar, pasi edhe kërkimi i udhëzimit të drejtë dhe mësimi i fesë është dije dhe kjo dije, pasi është fe, duhet të shikohet se nga kush mësohet. Muhamed Ibën Sirini, dijetari i madh musliman, njëkohësisht edhe nxënësi i njerit prej shtyllave të transmetimit të haditheve pejgamberike, Ebu Hurejrës, Allahu qoftë i kënaqur me të, ka thënë: "Pa dyshim që kjo dije është fe, prandaj shikoni se prej kujt po e merrni fenë tuaj."

Pra, shikoni, se prej kujt po e mësoni fenë tuaj, mësoni prej atyre që mbështeten në burime, argumente dhe interpretime të drejta nga Pejgamberi ynë dhe shokët e tij dhe jo prej atyre që mbështeten në imitime e fanatizëm të ndryshëm si dhe në grupime të devijuara!

Kërkojmë vazhdimisht prej Allahut udhëzimin në të vërtetën dhe pasi ta kemi kuptuar atë, të na bëjë të qëndrojmë stabil në të deri në momentet e ndërrimit të jetës!

Allahu është Dëgjuesi i lutjeve tona dhe Ai që përgjigjet!

Kryeredaktori!

BESIMI I MUSLIMANIT SUNNIJ SIPAS KUR'ANIT TË SHENJËT, HADITHIT TË SAKTË PEJGAMBERIK DHE RRUGËS SË TË PARËVE TANË TË MIRË (2)

11. Ç'është besimi-imani (përkufizimi i tij)?

Besim me zemër, shqiptim me gojë dhe veprim me gjymtyrë me përkushtim të sinqertë.

Allahu i Lartësuar thotë: *"O ju që keni besuar! Plotësoni detyrimin ndaj Allahut, kini frikë Atë dhe flisni gjithnjë të vërtetën! Ai do t'ju drejtojë juve tek veprat e mira e të drejta dhe do t'ju falë juve gjynahet tuaja. Kushdo që i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij, me të vërtetë që ka arritur fitoren më të madhe (do të pranohet në xhenetin e begatë)."*

Ahzab: 70-71

Muhamedi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, thotë: "Besimi është shtatëdhjetë e disa gradë; më e larta është fjala la ilahe il-lAllah dhe më e ulëta është largimi i pengesave nga rruga. Edhe turpi është gradë e besimit."

12. A lejohet fshehja e imanit (besimit)?

Patjetër që besimi i vërtetë duhet të vërtetohet, të tregohet.

Allahu i Lartësuar thotë: *"Arabët (e shkretëtirës) thanë: 'Ne besuam.' Thuaj (o Muhamed): 'Ju nuk besoni, por thoni: 'Ne jemi nënshtruar (në Islam)', pasi besimi nuk ka hyrë ende në zemrat tuaja. Por në qoftë se ju i bindeni Allahut dhe të Dërguarit të tij, Ai nuk do të pakësojë asgjë në shpërblimin për veprat tuaja. Vërtet që Allahu është gjithnjë Falës i Madh, Mëshirëplotë."* Huxhuratë: 14

Muhamedi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, thotë: "O ju që keni besuar (shprehur) me gjuhën tuaj dhe që nuk ka hyrë imani (besimi) në zemrat tuaja! Mos i mundoni besimtarët (muslimanët)." Sahih

13. Ku është Allahu i Lartësuar?

Allahu është në qiell, mbi Arsh, ashtu siç i takon Atij, të Lartësuarit.

Allahu i Lartësuar thotë: *"I Gjithëmëshirshmi (Allahu) Isteva (u ngrit lart dhe qëndroi) mbi Arsh*

(vërtet ashtu siç i shkon madhësisë së Tij)." Ta-Ha: 5

Muhamedi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, e pyeti atë robëreshën: "Ku është Allahu?" Ajo u përgjigj: "Në qiell". Atëherë ai, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, i tha zotërisë së saj: "Liroje atë, sepse ajo është besimtare."

Muhamedi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, thotë: "Me të vërtetë Allahu ka shkruar në një libër se 'Mëshira Ime i ka paraprirë (e ka tejkaluar) Hidhërimin Tim' dhe ai libër gjendet i shkruar tek Allahu, mbi Arsh." Buhariu

14. A është Allahu me ne me Qenien e Tij apo me Dijen e Tij?

Allahu është me ne me Dijen e Tij, na sheh dhe na dëgjon.

Allahu i Lartësuar thotë: *"Ai (Allahu) u tha: 'Mos u frikësoni, pa dyshim që Unë jam me ju të dy duke dëgjuar e shikuar çdo gjë.'" Ta-Ha: 46*

Muhamedi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, thotë: "Me të vërtetë ju i luteni Atij që dëgjon dhe është afër, Atij që është me ju." D.m.th, ju dëgjon dhe ju sheh juve. Muslimi

15. Cili është mëkati më i madh?

Mëkati më i madh është shokvënia Allahut.

Allahu thotë në Kuran: *"Dhe (kujto) kur Lukmani i tha birit të vet kur po e këshillonte: 'O biri im! Mos bashko të tjerë në adhurim me Allahun. Vërtet që bashkimi i të tjerëve në adhurim me Allahun është dhulm (padrejtësi, gabim) i madh (më i madhi)!"* Lukman: 13

Muhamedi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, është pyetur: "Cili është mëkati më i madh?" Ai tha: "T'i bësh Allahut rival, ndërsa Ai të ka krijuar ty." Muslimi

EMËRTIMET E EHLU SUNNETIT DHE XHEMATIT

Kush janë Ehlu Sunneti dhe Xhemati? Ata janë grupi i cili ra në konsensus që të pasojë dhe të veprorë sipas Sunnetit të Pejgamberit sal-IAllahu alejhi ve sel-lem haptazi dhe fshehtazi në bindje, fjalë dhe vepra. Ata janë sahabët, tabiinët, pasuesit e tyre dhe ata që ecin rrugës dhe metodologjisë së tyre prej imamëve të udhëzuar. Me këtë përkufizim, nga ky grup i ndritur kemi përjashtuar të gjitha grupimet e devijuara dhe pasuesit e tekave. Hoxha i Islamit, Ibën Tejmije, Allahu e mëshiroftë, thotë: "Ehlu Sunneti dhe Xhemati janë ata që i janë përmbajtur Islamit të pastër." [1] Ky titull përbëhet prej dy fjalësh, "Sunnet" dhe "Xhemat", sepse ka shumë që pretendojnë se janë prej Ehlu Sunnetit, por nuk janë prej xhematit, por janë me grupet e devijuara. Gjithashtu ka prej tyre që pretendojnë se janë me Xhematin, por nuk janë pasues të Sunnetit, por janë pasues të bidateve.[2] Me fjalën "Ehlu Sunneti" qëllimi është një nga këto dy kuptime:[3]

1. Ata që e pranojnë sundimin e tre halifëve të drejtë:[4] Këtu hyjnë të gjitha grupimet përveç "rafidive".[5] Ky kuptim është i njohur vetëm nga masa e rëndomtë e muslimanëve, por jo nga të tjerët.

2. Me ta qëllimi mund të jenë pasuesit e hadithit dhe Sunnetit autentik dhe këtu hyjnë vetëm ata që ia pohojnë Allahut cilësitë e përsosura, e pranojnë kaderin (çdo gjë që ndodh, ndodh me caktimin e Allahut) dhe thonë se Kur'ani nuk është i krijuar, por është Fjalë e Allahut dhe se besimtarët e shohin Allahun në botën tjetër, besimi është fjalë dhe vepër shtohet dhe pakësohet, besojnë në shenjat e ki-

[1] "Mexhmu'ul-fetava" (3\159).

[2] Bidat do të thotë "shpikje ne fe" dhe për këtë do të publikojmë tema të veçanta në numrat e ardhshëm të revistës sonë, në dashtë Allahu. (Shënim i kryeredaktorit).

[3] Shiko "Minhaxhus-suneh En-nebevije" (2/221) të Ibën Tejmijes.

[4] Ebu Bekri, Omeri dhe Othmani, Allahu qoftë i kënaqur me ta. Këta ishin tre udhëheqësit e parë pas vdekjes së Pejgamberit tonë, sipas renditjes së tyre. Me fjalën "kalif" kemi për qëllim udhëheqësin e muslimanëve.

[5] Me "rafidi" kemi për qëllim ekstremistët e shiitëve, të cilët pjesa dërmuese e dijetarëve muslimanë nuk i konsiderojnë prej muslimanëve (sh.k).

[6] Grupim i humbur që kanë folur rreth çështjeve të besimit me mendjet e tyre.

[7] Hadith ahad është ai hadith që e transmeton një person apo më shumë, qoftë edhe vetëm në një gjeneratë prej gjeneratave, por duke mos e arritur numri i transmetuesve shkallën e hadithit mutevatir. Mutevatir është hadithi të cilin në të gjitha gjeneratat e transmetojnë një grup transmetuesish duke larguar çdo dyshim për gabim apo gënjeshtër (sh.p).

[8] El-Xhebrije janë një drejtim i devjuar në çështje të kaderit, të cilët thonë se njeriu është i detyruar në të gjitha punët që bën dhe se njeriu nuk ka dëshirë të vetën. Pra, thonë se njeriu nuk është i lirë, por çdo gjë që vepron e bën pa dëshirën e tij, d.m.th. është i detyruar. Mendim të kundërt me ta kanë kaderitë, të cilët thonë se veprat e njeriut janë me dashjen e tij dhe se nuk janë të caktuara nga ana e Allahut, me fjalë të tjera nuk ka kader (sh.p).

ametit... e shumë gjëra të tjera prej bazamenteve të njohura te pasuesit e hadithit dhe Sunnetit. Dijetarët, kur shqiptojnë fjalët "Ehlu Sunneti", kanë për qëllim kuptimin e dytë, i cili u përmend në pikën e dytë, dhe sipas këtij kuptimi nuk hyjnë në rrethin e Ehlu Sunnetit dhe Xhematit grupe si esharitë dhe maturiditë sepse kanë kundërshtuar Ehlu Sunnetin dhe Xhematin në më shumë se gjashtëmbëdhjetë çështje. Disa prej këtyre çështjeve janë:

-Për sa u përket cilësive të Allahut, ata janë prej ehlu kelamit,[6] sipas metodës së atyre që i mohojnë dhe i shtrembërojnë cilësitë e Allahut.

-Ata e anashkalojnë tevhidin uluhije (njësimin e Allahut në adhurim), kur dihet se ai është prej bazave të fesë islame.

-I japin përparësi mendjes para teksteve të Kur'anit dhe Sunnetit.

-Nuk pranojnë hadithet *Ahad*[7] në çështje të besimit.

-Thonë se besimi është vetëm të vërtetuarit e një gjëje.

-Anojnë nga drejtimi i xhebrijve[8] në çështje të kaderit (caktimit të Allahut).

-Mohojnë uluvinin-qëndrimin e Allahut mbi qiej, mbi krijesat e Tij.

-Thonë se fjala e Allahut është fjalë në vetvete dhe me të kanë për qëllim të thonë se kinse Kur'ani është i krijuar.

-Mohojnë urtësinë e Allahut të Madhërihëm dhe shumë çështje të tjera. Ky emër, "Ehlu Sunnet", u përhap pas vrasjes së Othmanit, Allahu qoftë i kënaqur me të, dhe pas rebelimit të havarixhëve ndaj

Aliut dhe Muaviut, Allahu qoftë i kënaqur me ta, pasi i quajtnë ata të dy jomuslimanë dhe e lejuan gjakun dhe pasurinë e muslimanëve, pasi u shfaqën bidatet, si: bidati i shiitëve (rafidive), i murxhive, i kaderive. D.m.th. ky emër, "Ehlu Sunnet", u bë i njohur pas katër halifëve të drejtë, për të cilët i Dërguari i Allahut kishte urdhëruar që t'i përmbahemi rrugës së tyre kur të ndodhin kundërshtimet dhe sprovat.^[9]

Abdullah ibën Abasi, Allahu qoftë i kënaqur me të, kur komenton fjalën e Allahut: **"Në ditën kur ka fytyra që zbardhen dhe fytyra që nxihen..."** Alu Imran: 106, thotë: "Zbardhen fytyrat e Ehlu Sunnetit dhe nxihen fytyrat e pasuesve të bidateve dhe të përçarjeve."^[10] Imam Muhamed ibën Sirini, Allahu e mëshiroftë, thotë: *"Ata (sahabët) nuk pyesnin për senedin derisa ndodhi prova."*^[11] Kur ndodhi ajo, atëherë thanë: *"Na emërtoni njerëzit tuaj."* Atëherë shikohet: *nëse është nga Ehlu Sunneti, merret hadithi i tyre, ndërsa nëse është nga pasuesit e bidateve, nuk merret hadithi i tyre."*^[12]

Fjala fitneja (sprova) ka për qëllim shfaqjen e risive dhe të risimtarëve dhe jo fitnen mes Aliut dhe Muaviut, Allahu qoftë i kënaqur me ta, siç mendojnë disa injorantë. Nuk paramendohet që të thotë një sunnij, e lëre me një imam prej imamëve të tyre, siç është ibën Sirini të thotë: "se prej sahabëve kishte bidatçinj e të mos u merret hadithi", ndërkohë që Ehlu Sunneti e pranon hadithin e sahabëve.

Emrat e Ehlu Sunnetit dhe Xhematit

1. Grupi i shpëtuar: Ai është grupi i pastër në këtë botë nga bidatet dhe i shpëtuar në botën tjetër nga zjarri. I Dërguari i Allahut sal-IAllahu alejhi ve sellem ka garantuar se ai grup është i shpëtuar, kur thotë: **"Me të vërtetë itharët e librit (hebrenjtë dhe të krishterët) janë përçarë në shtatëdhjetë e dy grupe, ndërsa umeti im do të përçahet në shtatëdhjetë e tre grupe, të gjitha në zjarr përveç njërit, e ai grup është xhemati."**^[13]

Në një transmetim tjetër thuhet: "Sahabët i thanë:

"Cili është ai grup, o Resulallah?" Resulullahu tha: "Ata janë në atë që jam unë dhe shokët e mi."^[14] Hoxha i Islamit, Ibën Tejmije, Allahu e mëshiroftë, thotë: "Në qoftë se cilësi e "grupit të shpëtuar" ishte pasimi i sahabëve, kur dihet se ky pasim i tyre ishte shenjë e Ehlu Sunnetit, atëherë grupi i shpëtuar është Ehlu Sunneti."^[15] Gjithashtu ka thënë: "Ata që e meritojnë më shumë për të qenë grup i shpëtuar janë pasuesit e hadithit dhe Sunnetit, të cilët nuk pasojnë dikë tjetër e nuk kapen vetëm se pas Resulullahut sal-IAllahu alejhi ve sellem dhe janë më të dijshtim për fjalët dhe gjendjen e tij..."^[16] Ky emërtim është bërë i njohur në librat e Ehli Sunnetit, saqë edhe dijetari Ibën Bet-ta e ka titulluar librin e tij "Qartësimi i rregullave të grupit të shpëtuar"^[17], kurse Ibën Kajimi e ka emërtuar librin e tij "el-Nunije": "El kafijetu esh-shafije fi el intisari li firkati en-naxhije".

2. Grupi i ndihmuar: Grup i ndihmuar dhe i përkrahur (nga Allahu) ndaj kundërshtarëve me argumente e nganjëherë i përkrahur edhe me forcë. I Dërguari i Allahut sal-IAllahu alejhi ve sellem thotë: **"Do të vazhdojë një grup nga umeti im, do të jenë të ndihmuar, nuk u bëjnë dëm atyre ata që nuk i ndihmojnë dhe as ata që i kundërshtojnë, derisa të ndodhë kiameti."**^[18]

Në një transmetim thuhet: **"Do të vazhdojnë njerëz nga umeti im haptazi ta mbrojnë të vërtetën, derisa t'u vijë vdekja e ata do të jenë këshu."**^[19]

Imam Ali ibën El-Medinij, Allahu e mëshiroftë, thotë; "Ata janë pasuesit e hadithit."^[20]

Imam Neveviu, Allahu e mëshiroftë, thotë: "Megjithëkëtë ata kanë në vete vlera të qarta dhe në ruajtjen e diturisë argumente të forta. Në dy sahihat transmetohet se Resulullahu sal-IAllahu alejhi ve sellem ka thënë: "Do të vazhdojë një grup... dhe përmendi hadithin e lartpërmendur. Në fund tha: "Shumica e dijetarëve janë të mendimit se ai grup janë mbartësit e diturisë."^[21]

Dijetari i madh el-Menavij, Allahu e mëshiroftë, thotë: "Në këtë hadith ka mrekulli të qartë sepse

[9] Shiko "El-Mufhim" të Kurtubiut (1\122-123), Mexhmu fetava (10\35-36).

[10] El-Axhurrij në "Esh-sheria" (2074), Lalikai në "Sherh usul i'tikad ehli suneh" (74) dhe të tjerë.

[11] Me sprovën këtu është fjala për vrasjen e Othmanit, Allahu qoftë i kënaqur me të.

[12] Muslimi në "Parathënie" (1\15).

[13] Ahmedi (3\102), Ebu Davudi (4586), ibn Maxheh (3992), Darimi (2518), Hakimi (1\128), shiko edhe "Es-silsiletu es-sahiha" (204, 1492).

[14] Tirmidhiu (2641), Hakimi (1\128-129).

[15] Minhaxh es-suneh (3\457).

[16] Mexhmu fetava (3\348).

[17] "El ibaneh an sheriati el firkati en-naxhije".

[18] Ahmedi (4\563), Tirmidhiu (2192), Ibën Maxheh (6), El-halekai (172), shiko në "Silsile Es-sahiha"

[19] Buhariu (7311), Muslimi (1921).

[20] Tirmidhiu (4\485), Hatib El Bagdadij në "Sherefu as'habil hadithi", (faqe 30).

[21] Teh'dhib el-esma vel-lugat (1\17).

Ehlu Sunneti vazhdojnë të jenë ngadhënjimtarë deri në ditët e sotme që nga koha kur janë shfaqur risitë (bidatet) e të gjitha llojeve nga havarixhët, mu'tezilitë, rafiditë e të tjerët, të cilët nuk kanë pasur kurrë një shtet të tyre. Ata nuk e kanë pasur të gjatë dhe çështja e tyre është zhdukur sa herë që janë munduar të ndezin përçarje dhe luftë, Allahu e ka shuar atë me dritën e Kur'anit dhe Sunnetit. Dhuntia është e Allahut dhe falënderimi i takon Atij." [22]

3. Xhemati: Janë ata që bien në ujdj për të punuar me Kur'an dhe Sunnet, për të respektuar udhëheqësit e tyre dhe dijetarët në punët e mira. Kjo është cilësi e domosdoshme e Ehlu Sunnetit. Ky emërtim vërtetohet në hadithin e lartpërmendur: **"Me të vërtetë ithtarët e libri (hebrenjtë dhe të krishterët) janë përçarë në shtatëdhjetë e dy grupe, ndërsa umeti im do të përçahet në shtatëdhjetë e tre grupe, të gjitha në zjarr përveç njërit. Dhe ai grup është xhemati."** [23]

Hoxha i Islamit, Ibën Tejmije, thotë: "Janë quajtur pasues të xhematit sepse fjala xhemat aludon për bashkim dhe e kundërta e saj është përçarja, edhe pse fjala xhemat thuhet edhe për një grup njerëzish të bashkuar." [24]

4. Pasuesit e hadithit: Ibën Tejmije, Allahu e mëshiroftë, thotë: "Nuk kemi për qëllim me "pasuesit e hadithit" ata të cilët e dëgjojnë hadithin, e shkruajnë atë apo e transmetojnë, por kemi për qëllim çdo person që e mëson hadithin, e njëj atë, e kupton në çështje të jashtme dhe të brendshme dhe e pason atë në të gjitha sferat e jetës, në çështje të jashtme dhe të brendshme." [25]

Halifi Harun Err-Rreshid, Allahu e mëshiroftë, ka thënë: "Hulumtova për katër gjëra, derisa i gjeta ato në katër grupe. Hulumtova për kufrin (mosbesimin) dhe e gjeta te xhehmitë, hulumtova për ilmul-ke-lamin (apologjetikën) dhe e gjeta te mu'tezilitët, hulumtova për gënjeshtërën dhe e gjeta te rafiditë, por kërkova të vërtetën dhe e gjeta te pasuesit e hadithit." [26] Imam Ebu Othman Es-Sabunij e ka

emërtuar një libër të tij "Akidet-us-selef as'habu el hadithi".

5. Selefite: Hoxha i Islamit, Ibën Tejmije, Allahu e mëshiroftë, thotë: *"Nuk ka asgjë të keqe nëse dikush shfaq drejtimin e selefëve (të parëve tanë të mirë), anon nga ata dhe krenohet se është pasues i tyre. Jo që ka të keqe, por është obligim që të pranohet unanimitisht nga secili që e bën këtë, pasi drejtimi i selefëve nuk është tjetër vetëm se i vërtetë."* [27] Gjithashtu thotë: *"Pre-tendimi për ndjekjen e selefite asesi nuk ka mundësi të jetë prej shenjave të bidatçinjve, kjo është e kotë dhe është e pamundur, përveç kur shtohet injoranca dhe pakësohet dituria."* [28] Dijetari i madh es-Sefarinu, Allahu e mëshiroftë, thotë: "Kur përmendet drejtimi i selefite qëllimi është ajo në të cilën kanë qenë shokët e ndershëm të Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sellem, Allahu qoftë i kënaqur me ta, pastaj pasuesit e sahabëve më të mirë, pastaj imamët e fesë për të cilët është dëshmuar se janë imamë të mëdhenj dhe dijetarë dhe njerëzit fjalët e tyre i kanë pranuar gjeneratë pas gjenerate." [29]

6-Pasuesit e etherit (argumenteve): Ata janë kapur pas Kur'anit, haditheve të vërteta dhe fjalëve të selefëve prej sahabëve, tabiinëve e të tjerëve në fjalë, vepër dhe i'tikad (bindje).

Imam Ahmedi, Allahu e mëshiroftë, thotë: *Feja e Pejgamberit Muhamed është ahbare* [30] *Sa zbatim i mirë për njeriun janë atharet Mos u largoni nga hadithi dhe pasuesit e tij Sepse logjika është terr e hadithi dritë. Ndoshta njeriu i humb gjurmët e udhëzimit Por dielli qëndron lart e shndrit.* [31]

Imam Ebu Hatim err-Rrazij, Allahu e mëshiroftë, ka thënë: **"Shenjë e bidatçinjve është se ata flasin për pasuesit e etherit."** [32]

Shkëputur nga libri "El-Mukaddimeh er-Reshideh" të Dr. Muhamed Alu Nasër Përshtati: Fidan Xhelili

[22] Fejdul-kadir (6\395).

[23] Ahmedi (3\102), Ebu Davudi (4586), Ibën Maxheh (3992), Darimiu (2518), Hakimi (1\128), shiko edhe "Es-silsiletu es-sahiha" (204, 1492).

[24] Mexhmu fetava (3\175).

[25] Mexhmu fetava (4\95).

[26] El-Hatib në "Sheref as'habul hadith" (104).

[27] Mexhmu fetava (4\149).

[28] Mexhmu fetava (4\157).

[29] Levamiu el-envar (1\20).

[30] Ahbare d.m.th. ato që vijnë nga Allahu dhe i Dërguari i Tij prej ligjeve, rregullave, paralajmërimeve etj.

[31] Ibn Abdul-Berri në "Xhami bejan el ilm ve fadlih" (1459).

[32] Shiko librin tonë "Ediletul vahjejn fi sherh akidet err-Rraziejn", faqe 416-419.

Shokët e Pejgamberit tonë dhe vlerat e tyre

S'ka dyshim se Allahu e dërgoi Muhamedin sal-IAllahu alejhi ve sel-lem me udhëzimet dhe fenë e vërtetë atëherë kur bota jetonte në errësisën e injorancës, larg edukatës njerëzore, e zhytur thellë në politeizëm dhe adhurime të kota.

Allahu zgjodhi Muhamedin sal-IAllahu alejhi ve sel-lem, zotërinë e Pejgamberëve, imamin dhe vulën e të Dërguarve, ashtu siç e zgjodhi edhe Islamin si plotësim të feve dhe legjislacioneve të mëhershme dhe normave të plota edukativo-morale.

Allahu zgjodhi burra shoqëruar të të Dërguarit sal-IAllahu alejhi ve sel-lem, të cilët e mbartën fenë e çmuar të tij duke e përcjellë te brezat që vijnë pas tyre, duke çuar në vend amanetin që u ngarkoi Allahu, duke ua lartësuar argumentet e Allahut njerëzve në përgjithësi. E, si të mos të jetë kështu kur Allahu i pastroi dhe i zgjodhi? Allahu në Kur'an thotë: **“Zoti yt krijon çka të dojë dhe zgjedh kë të dojë.”** Kasas: 68

Pa dyshim ata ishin njerëzit më besnikë në dashurinë, ndihmën, mbrojtjen dhe respektimin e të Dërguarit dhe fesë së tij, duke na dhënë shembuj të shumtë në dashurinë parësore ndaj Allahut dhe të Dërguarit të tij përballë vetes, pasurisë dhe familjes. Ata shpenzuan pasurinë dhe jetën në kompensim të kënaqësisë së Allahut me të vetmin synim, që fjala e Allahut të ngrihet lart, duke vërtetuar sinqeritetin dhe besimin e tyre ndaj Muhamedit sal-IAllahu alejhi ve sel-lem, të Dërguarit të mëshirës dhe udhëzimit, duke besuar atë që ka ardhur me të, pastaj duke e respektuar, ndihmuar dhe pasuar dritën me të cilën Allahu e pajisi.

Ata braktisën familjet, prindërit, vendin e tyre dhe si kompensim të vetmin kishin Islamin, duke i udhëzuar njerëzit e humbur, duke i nxjerrë ata nga errësira e injorancës dhe e shfrenimit në

dritën e Kur'anit dhe të besimit, duke mbartur me vete dhe duke transmetuar amanetin dhe trashëgiminë e të Dërguarit sal-IAllahu alejhi ve sel-lem te të tjerët në lindje dhe perëndim. Nuk ka argument më bindës se varret e tyre në çdo cep të botës, që aludon se ata ishin burra që e morën fenë nga Muhamedi sal-IAllahu alejhi ve sel-lem dhe e përhapën te të tjerët. Gjithë këtë e bënë duke mos kërkuar kompensim nga kjo dynja dhe zbukurimet e saj, pasi ishin burra që ia dhanë premtimin Allahut dhe e mbajtën atë. Allahu në Kur'an thotë: **“Prej besimtarëve kishte burra që vërtetuan besën e dhënë Allahut, e disa prej tyre e realizuan premtimin duke dhënë jetën, dhe ka prej tyre që janë duke pritur (ta zbatojnë) dhe ashtu nuk bënë kurrfarë ndryshimi.”** Ahzab: 23

“Po, ata që besuan, migruan dhe luftuan për rrugën e Allahut dhe ata që strehuan dhe ndihmuar, janë besimtarë të vërtetë. Atyre u takon falja (e mëkateve) dhe furnizimi në mënyrë të ndershme.” Enfal: 74.

“Muhamedi është i Dërguar i Allahut e ata që janë me të (sahabët) janë të ashpër kundër jobesimtarëve, janë të mëshirshëm ndërmjet vete, ti i sheh tek përulen (në rukuë), duke rënë me fytyrë në tokë (në sexhde) e kërkojnë prej Allahut që të ketë mëshirë dhe kënaqësinë e Tij ndaj tyre. Në fytyrat e tyre shihen shenjat e gjurmës së sexhdes. Përshkrimi i cilësive të tyre është në Tevrat dhe po ky përshkrim është edhe në Inxhil. Ata janë si një farë e mbjellë, ku mbin filizi i vet, e ai trashet, përforcohet dhe qëndron në trungun e vet, ajo e mahnit mbjellësin.” (Allahu i shumoi) **Për t'ua shtuar me ta mllëfin jobesimtarëve. Allahu atyre që besuan dhe bënë vepra të mira u premtoi falje të mëkateve dhe shpërblim të madh.”** Fet'h: 29

Muhamedi sal-IAllahu alejhi ve sel-lem thotë:

“Yjet janë mbrojtësit e qiellit, e nëse yjet shkojnë, atëherë vjen qielli me atë që është premtuar. Unë jam mbrojtës dhe ruajtës i sahabëve, e kur unë të shkoj, atëherë vijnë sahabët me atë që është premtuar. E, sahabët janë mbrojtës të umetit tim, e nëse ata shkojnë, atëherë umeti vjen me atë që është premtuar.” Transmeton Muslimi
Duke u bazuar në këto argumente, atëherë vendosa të përgatitja diçka rreth këtyre burrave me shpresë se Allahu do të dhurojë sukses, kur dihet se: **“Allahu i mbron atë të cilët besuan.”** Haxh: 38

Sahabët në Kur'an dhe Sunnet

Nëse shikojmë argumentet nga Kur'ani dhe Sunneti, del shumë qartë vlera madhore e sahabëve dhe pesha e lartë e tyre, pozita në të cilin ishin ata burra që Allahu i zgjodhi dhe i dëliri në shoqërimin e Muhamedit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, në mbrojtjen e fesë së Tij, të cilët i qëndruan besnik besimit të tyre tek Allahu dhe i Dërguari i Tij duke luftuar me pasurinë dhe jetët e tyre në rrugën e ngritjes dhe fitores së fesë së Tij.

Ishin ata që mbartën mesazhin te ne, me sinqeritet dhe mund, derisa u përforcua feja dhe nëpërmjet tyre Allahu e zgjeroi fjalën e Tij në rruzullin tokësor. E gjithë kjo është për t'u lavdëruar dhe respekti u takon atyre nga çdo musliman deri në Ditën e Gjykimit.

S'ka dyshim se Allahu këta burra i lavdëroi në Kur'an:

“Ju jeni populli më i dobishëm, i ardhur për të mirën e njerëzve.” Al Imran: 110

“Ne ju bëmë një popull të drejtë (një mes të zgjedhur) për të qenë ju dëshmitarë (në Ditën e Gjykimit) ndaj njerëzve.” Bekare: 143

Pa dyshim se këtë e përforcon fjala e Muhamedit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem: “Umeti më i mirë është shekulli im, pastaj ata që vijnë pas tyre, pastaj ata që vijnë pas tyre. E në një transmetim tjetër: “Njerëzit më të mirë janë shekulli im, pastaj ata që vijnë pas tyre, pastaj ata që vijnë pas tyre.”

Pastaj prapë Allahu duke treguar vlerën dhe pozitën e tyre thotë: **“Allahu është i kënaqur me të hershmit e parë prej muhaxhirëve (migruesve) dhe prej ensarëve (vendasve ndihmëtarë) dhe prej**

atyre që i pasuan ata me punë të mira, por edhe ata janë të kënaqur ndaj Tij. Atyre u ka përgatitur xhenete, në të cilët rrjedhin lumenj, ku do të jenë përjetë të pasosur. E ky është fitim i madh.”

Tevbe: 100

“Nuk janë të barabartë prej jush ata që dhanë nga pasuria e tyre dhe luftuan para çlirimit sepse të tillët kanë vlerë më të madhe nga ata që dhanë dhe luftuan pas. Por të gjithëve Allahu u premtoi të mirat; Allahu di çka punoni.” Hadid: 10

“Vërtet, Allahu që i kënaqur me besimtarët kur ata nën hijen e atij druri të zotoheshin ty dhe Ai e dinte se ç'kishin zemrat e tyre, prandaj u dhuroi qetësimin dhe së shpejti i shpërbleu me një fitore (çlirimin e Hajberit).” Fet'h: 18

“Po, ata që besuan, migruan dhe luftuan për rrugën e Allahut dhe ata që strehuan dhe ndihmuan janë besimtarë të vërtetë. Atyre u takon falja (e mëkateve) dhe furnizimi në mënyrë të ndershme.” Enfal: 74

Pa dyshim që kemi edhe ajete të tjera që tregojnë vlerën dhe faljen që Allahu ua ka dhënë këtyre burrave.

Sahabët në hadithet e Muhamedit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem

“Yjet janë mbrojtësit e qiellit, e nëse yjet shkojnë, atëherë vjen qielli me atë që është premtuar. Unë jam mbrojtës dhe ruajtës i sahabëve, e kur unë të shkoj, atëherë vijnë sahabët me atë që është premtuar. E, sahabët janë mbrojtës të umetit tim, e nëse ata shkojnë, atëherë umeti vjen me atë që është premtuar.” Transmeton Muslimi

“Nuk ka për të hyrë në zjarr asnjë nga banoret e pemës (ata që ishin prezent me Muhamedin sal-lAllahu alejhi ve sel-lem kur u bë marrëveshja e Hudejbijes) me lejen e Allahut.” Transmeton Muslimi

Sahabët në gjuhën e selefëve

Abdullah ibën Me'udi: “Allahu shikoi zemrat e njerëzve dhe gjeti zemrën e Muhamedit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem më të mirën, prandaj e pastroi për Vetën e Tij, duke e bërë të Dërguar të Tij. Pastaj shikoi zemrat e njerëzve pas Muhamedit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem dhe gjeti zemrat e sahabëve zemrat më të mira, duke i bërë ata min-

istra të tij, që luftojnë në mbrojtje të fesë së Tij. Atë që muslimanët e shohin të mirë, ajo tek Allahu është e mirë e atë që muslimanët e shohin të keqe, ajo tek Allahu është e keqe.” Musned Imam Ahmedi 1/379

Fyerja dhe ofendimi i sahabëve

S’ka dyshim se fyerja apo ofendimi i sahabëve është nga gjërat e refuzuara, veprim të cilin e bëjnë vetëm zemërsëmurët dhe shiitët e mallkuar, prandaj është obligim i çdo muslimani të dalë në mbrojtjen e sahabëve.

Argumentet nga Kur’ani se ofendimi dhe fyerja e tyre është e ndaluar

“E s’ka dyshim se ata janë të cilët e fyejnë Allahun dhe të Dërguarin e Tij, ata i ka mallkuar Allahu në dynja e në ahiret dhe për ta ka përgatitur një dënim të dhimbshëm.” Ahzab: 57

Ata që fyejnë sahabët e të Dërguarit, fyejnë të Dërguarin. E, kush fyen të Dërguarin, ka fyer Allahun. E, kush fyen Allahun, është prej të mallkuarve.

Argumentet nga hadithet e Muhamedit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem

Muhamedi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë:

“Mos i ofendoni shokët e mi, se pasha Atë në Dorën e të Cilit është jeta ime, nëse dikush nga ju jep sa kodra e Uhudit, nuk e arrin aq sa ata kanë dhënë një grusht.” Buhariu dhe Muslimi

“Kush ofendon shokët e mi, mbi të qoftë mallkimi i Allahut, i melekëve dhe i njerëzimit në përgjithësi!” Sahih el Xhami’: 6285

Pra, ju përgëzoj o shiitë, rafidi dhe havarixhë, o ju që po ofendomi sahabët, se mallkimi i Allahut po ju mbulon!

“Kur të përmenden shokët e mi, ndaluni. Kur të përmenden yjet, ndaluni dhe kur të përmendet përcaktimi, ndaluni.” Sahih el Xhami’: 3595

Fjalët e selefëve

Ahmed ibën Hambeli: “Nga argumentet e qarta dhe të ndritshme janë përmendja e të mirave për sahabët dhe fshehja e mangësive, duke u larguar nga mospajtimet që ata kanë pasur mes tyre. E,

kush i ofendon shokët e Muhamedit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem apo njërin prej tyre ose shpif për ta apo për ndonjërin prej tyre, pa dyshim se i tilli është bidatçi, rafidi, i fëlliqur. E, Allahu nuk pranon prej tij asnjë vepër.”

“Dashuria për ta është sunnet, lutja për ta afrim tek Allahut, pasimi i tyre mjet, kapja për gjurmët e tyre mirësi. Shokët e Muhamedit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ishin njerëzit më të mirë, nuk i lejohet askujt të përmendë diçka nga mangësitë e tyre e as t’i ofendojë apo të shpikë diçka për ta.” Suneni i Imam Ahmedit, 78

Imam Tahaviu thotë: “I duam shokët e Muhamedit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem duke mos e tepruar në dashuri për asnjërin prej tyre, duke mos u distancuar nga asnjëri prej tyre. Urrejmë këdo që i urren ata, edhe atë të cilin i përmend për jo të mirë. Ne i kujtojmë ata vetëm për të mirë, dashuria për ta është fe, besim dhe mirësi, kurse urrejtja e tyre është kufër, dyfytërsi dhe mohim.” Sherhul-akideti et Tahavijje, faqe 467

Referenca:

“El Itikadu el vaxhibu, nahve Sahabeti”, Shejh Falih Ismajil.

“Es Sahabetu”, Ebu Islam Salih ibën Taha Abdul Vahid.

Përgatiti: Unejs Murati

KUSH ËSHTË PEJGAMBERI YT? SHPALLJA E TIJ

Muhamedi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem u dërgua kur ishte dyzet vjeç. Meleku i zbriti atij derisa ishte në shpellën Hira ditën e hënë, më 17 Ramazan. Kur i zbriste shpallja, kishte mundim, saqë fytyra dhe balli i djsitej. Kur i zbriti meleku, i tha: "Ikrel!" - "Lexo, mëso!" "Unë nuk di të lexoj", u përgjigj Muhamedi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem.

Pastaj vazhdoi: "Më mori në përqaftim dhe më shtrengoi aq sa më kaploi mundimi. Këtë e përsëriti tri herë, e pastaj më lëshoi dhe më tha: **"Lexo në emër të Zotit tënd, i cili ka krijuar (çdo gjë). Ka krijuar njeriun prej gjaku të ngjizur. Lexo, se Zoti yt është më bujari, që ia mësoi njeriut pendën (të shkruajë), që njeriut ia mësoi atë që nuk dinte."** Alak: 1-5

Muhamedi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem pastaj kthehet në shtëpi i tronditur dhe i shqetësuar, shkon te Hatixhja, e bija e Huvejlidit, Allahu qoftë i kënaqur me të, së cilës i thotë: "Më mbulo! Më mbulo!" dhe i tregon asaj "lajmin" dhe i thotë: "Kam pasur frikë për veten." Hatixhja, Allahu qoftë i kënaqur me të, i përgjigjet: "Jo, jo për Zotin, Allahu ty kurrë nuk do të turpërojë, sepse ti je njeri i cili i viziton të afërmit e tu, kujdesesh për të varfrit, e kompenson të humburën, e gostit musafirin, gjithnjë i ndihmon të tjerët dhe ndjek të drejtën".

Shpallja u ndërpre dhe Muhamedi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem qëndroi aq sa deshi Allahu të qëndrojë duke mos vërejtur asgjë. Ai u pikëllua dhe u mallëngjye për shpalljen, pastaj iu paraqit meleku mes qiellit dhe tokës në një ulëse, e përforcoi dhe e përgëzoi se me të vërtetë ishte i Dërguar. Kur e pa ashtu, Muhamedi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem u frikësua prej tij dhe vrapoi te Hatixhja dhe i tha: "Më mbuloni! Më mbuloni!" Ata e mbuluan, pastaj Allahu i lartmadhërisëm shpalli: **"O ti i mbuluar, ngrihu dhe tërhiq vërejtjen!** (duke i thirrur)." E urdhëroi Allahu me

këtë ajet që të thërrasë popullin e tij. Muhamedi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem u ngrit në respektim të thirrjes më të plotë, duke i thirrur për tek Allahu të vegjlit dhe të rriturit, robërit dhe të lirët, burrat dhe gratë, të bardhët dhe të zinjët. Iu përgjigjën ftesës së tij robërit e Allahut nga çdo fis, ata të cilët Allahu deshi t'i shpëtojë në dunja dhe në ahiret. Ata hynë në Islam me dritë dhe syçeltësi dhe i duruan torturat e mendjelehtëve të Mekës.

Allahu e mbrojti Muhamedin sal-lAllahu alejhi ve sel-lem përmes Ebu Talibit, ngase ishte me pozitë të lartë në mesin e tyre, prandaj ata nuk e lëndonin atë, pasi e dinin se ai ishte i dashur për Ebu Talibin.

Ibën Xhevziu thotë: "Muhamedi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem thirri tre vite fshehurazi, pastaj Allahu zbriti fjalën e Tij:

"Publiko haptas atë për të cilën urdhërohesh."

Hixhër: 94

Pra, e publikoi thirrjen, pastaj zbriti edhe ajeti tjetër: **"Dhe tërhiqju vërejtjen fafesisit tënd më të afërt."** Shuara: 214

I Dërguari i Allahut u ngrit në kodrën Safa duke thirrur: "O ju të hershmit!" Thanë: "Kush është ai që po thërrret?" Thanë: "Muhamedi! Bashkohuni rreth tij!" Tha pastaj: "O fisi i filanit, o fisi i filanit, o fisi i filanit, o fisi AbdulMenaf, o fisi AbdulMutilib!", atëherë u bashkuan rreth tij. Muhamedi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem tha: "Sikur t'ju them se një kalorës del nga kjo kodër, a do më kishit besuar?" Thanë: "Nuk na ke gënjyer kurrë." Ai vazhdoi: "Pra, unë jam tërheqës i vëmendjes nga dënimi i ashpër!" Ebu Lehebi i tha: "I shkatërruar qofsh! A për këtë na ke bashkuar?" Pastaj u ngrit dhe u largua. Me këtë rast zbriti ajeti i Kur'anit:

"Qoftë i shkatërruar Ebi Lehebi, e ai më është shkatërruar!" Mesed: 1

Durimi i Muhamedit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ndaj torturave.

Muhamedi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem u torturua nga populli i tij, mirëpo ai ishte durimtar, duke shpresuar tek Allahu, pastaj urdhëroi shokët e tij që të emigrojnë në Etiopi, duke ikur nga padrejtësitë dhe torturat, prandaj edhe emigruan. Ibën Is'haku thotë: "Kur vdiq Ebu Talibi, atëherë iu vërsulën kurejshët Muhamedit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem me tortura, atë që nuk mundën ta bënë derisa ai ishte gjallë. Ebu Naimi transmeton nga Ebi Hurejra, Allahu qoftë i kënaqur me të: "Kur vdiq Ebu Talibi, u vërsulën kurejshët ndaj Muhamedit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem. Atëherë Muhamedi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem tha: "Xhaxhā im, sa shpejt e ndjeva mungesën tënde!"

Transmetohet në Buhari dhe Muslim se Muhamedi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ishte duke u falur nën hijen e një peme, atëherë erdhi Ukbete ibën Ebi Mu'iti dhe i hodhi diçka mbi supet Muhamedit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, ndërsa ai mbeti ashtu në sexhde derisa erdhi Fatimja dhe ia largoi nga shpina e tij dhe tha: "O Allah, dënoji kurejshët!" Ndërsa në një transmetim tjetër të Buhariut thuhet se Ukbete ibën Ebi Mu'iti një ditë e kapi Muhamedin sal-lAllahu alejhi ve sel-lem duke ia shtrënguar shumë jakat e tij. Në këto momente erdhi Ebu Bekri, e largoi nga ai dhe i tha: "A po vrisni njeriun i cili po thotë se Zoti im është Allahu?"

Mëshira e Muhamedit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ndaj popullit të tij

Muhamedit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem iu shtuan torturat nga populli i tij, posaçërisht pas vdekjes së Ebu Talibit dhe Hatixhes, gruas së tij. Atëherë Muhamedi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem udhëtoi për në Taif duke i thirrur fiset e tyre në Islam. Përgjigja e tyre ishte injorim, nënçmim, tortura dhe gjuajtje me gurë, saqë e përgjakën. Muhamedi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem vendosi të kthehet në Mekë. Muhamedi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem thotë: "Vendosa të kthehem nga Taifi dhe në fytyrën time vëreheshin shenjat e pikëlimit. Nuk e hetova veten vetëm derisa u gjenda afër Thealibit, ngrita kokën dhe mbi pashë një re

të vogël që më bënte hije, prandaj shikova më mirë dhe pashë se në të qëndronte Xhibrili, i cili m'u drejtua: "Allahu ka dëgjuar çfarë u ke thënë atyre dhe ç'përgjigje të kanë dhënë. Allahu ta dërgon engjëllin e kodrave, të cilin mund ta urdhërosh t'u bëjë çfarë të duash atyre." Pastaj dëgjova zërin e engjëllit, i cili më tha: "O Muhamed, ja ku jam. Çfarë dëshiron të bëj? Nëse dëshiron t'i rrëzoj këto dy kodra, El-Ahsheban, mbi ta, vetëm më thuaj." Muhamedi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem tha: "Dëshiroj që Allahu xheleshanuhu prej tyre të shpjerë në rrugë të drejtë ata të cilët do të besojnë Allahun e Lartësuar, Një, të Vetmin që meriton adhurim, dhe nuk do të bëjnë shirk, nuk do t'i përshkruajnë Atij zota të tjerë." Muttefekun alejhi

Muhamedi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem dilte për çdo marsh dhe ua paraqite çdo fisi Islamit duke thënë: "Kush më mbron mua? Kush më ndihmon mua? Kurejshët më ndaluan të shpall fjalën e Allahut." Pastaj Muhamedi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem takoi në Akabe gjashtë persona, i thirri në Islam dhe e pranuan atë, pastaj ata u kthyen në Medinë dhe thirrën popullin e tyre derisa u përhap Islami mes tyre. Pastaj ndodhi betimi i parë në Akabe dhe i dyti fshehurazi, derisa u sigurua shpërngulja për në Medinë, e cila ndodhi pastaj.

Shpërngulja e Muhamedit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem në Medinë

Muhamedi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem doli me Ebu Bekrin dhe u nisën drejt Medinës, mirëpo u ndalën në shpellën Hira duke qëndruar aty tri ditë, por fshehurazi nga kurejshët. Pastaj hynë në Medinë të mirëpritur nga banorët e saj, ku filloi edhe ngritja e xhamisë.

Luftërat e tij sal-lAllahu alejhi ve sel-lem

Ibën Abbasi, Allahu qoftë i kënaqur me të, transmeton duke thënë: "Kur Muhamedi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem doli nga Meka, Ebu Bekri tha: "E nxorën Pejgamberin e tyre, të Allahut jemi dhe tek ai do kthehem. Ata do të shkatërrohen." Pastaj zbriti ajeti: "U është dhënë leje të luftojnë për shkak se u është bërë padrejtësi." Haxh: 39 Është ajeti i parë që ka zbritur sa i përket luftës.

Muhamedi sal-IAllahu alejhi ve sel-lem mori pjesë në njëzet e shtatë beteja, duke luftuar në nëntë prej tyre.

Haxhi dhe umreja e Muhamedit sal-IAllahu alejhi ve sel-lem

Muhamedi sal-IAllahu alejhi ve sel-lem ka bërë vetëm një haxh pasi u shpërngul në Medinë dhe ai është Haxhi Lamtumirës, ndërsa umre ka bërë katër herë, të gjitha në muajin Dhulkade, përveç atij të haxhit.

Ngjarjet më të rëndësishme

- 1. Israja dhe Miraxhi:** Ndodhën 3 vite para shpërnguljes në Medinë, kur u bë obligim edhe namazi.
- 2. Viti i parë:** Shpërngulja, ndërtimi i xhamisë dhe themelet e shtetit islam, obligueshmëria e zekatit.
- 3. Viti i dytë:** Lufta e madhe e Bedrit, në të cilën Allahu i ngriti besimtarët dhe nënçmoi jobesimtarët.
- 4. Viti i tretë:** Lufta e Uhudit, ku e pësuan muslimanët sepse kundërshtuan urdhrat e Muhamedit sal-IAllahu alejhi ve sel-lem duke shikuar plaçkën e luftës.
- 5. Viti i katërt:** Lufta me fisin Nadir, në të cilën Muhamedi sal-IAllahu alejhi ve sel-lem dëboi nga Medina fisin Nadir ngase kishin prishur kontratën që kishin me muslimanët.
- 6. Viti i pestë:** Lufta e fisit Mutlak, lufta Ahzab dhe lufta me fisin Kurejdha.
- 7. Viti i gjashtë:** Marrëveshja e Hudejbisë, në këtë vit gjithashtu u ndalua alkooli rreptësisht.
- 8. Viti i shtatë:** Lufta e Hajberit dhe viti kur Muhamedi sal-IAllahu alejhi ve sel-lem dhe shokët e tij hynë në Mekë dhe bënë umren. Gjithashtu në këtë vit Muhamedi sal-IAllahu alejhi ve sel-lem u martua me Safijen, bijën e Hujejit.
- 9. Viti i tetë:** Lufta e Mu'tes mes muslimanëve dhe romakëve, çlirimi i Mekës, lufta e Hunejnit kundër fisit Havazen dhe Thekif.
- 10. Viti i nëntë:** Lufta e Tebukut, që është edhe lufta e fundit e Muhamedit sal-IAllahu alejhi ve sel-lem. Në këtë vit erdhën shumë delegacione të Muhamedi sal-IAllahu alejhi ve sel-lem dhe e

pranuan Islamin shumë njerëz, duke hyrë në të grupe-grupe. U quajt edhe viti i delegacioneve.

11. Viti i dhjetë: Haxhi Lamtumirës, kur me Muhamedin sal-IAllahu alejhi ve sel-lem e bënë haxhin edhe njëqind mijë muslimanë.

12. Viti i njëmbëdhjetë: Vdekja e Muhamedit sal-IAllahu alejhi ve sel-lem në ditën e hënë në muajin Rrebi' el Evel, duke mos anashkuar edhe kundërthëniet rreth saktësisë së datës së këtij muaji.

Vdiq Muhamedi sal-IAllahu alejhi ve sel-lem në moshën gjashtëdhjetë e tre vjeç. Dyzet vite i jetoi para shpalljes dhe njëzet e tre vite pas shpalljes. Prej tyre trembëdhjetë vite në Mekë dhe dhjetë vite në Medinë.

Paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi Muhamedin alejhi selam!

Shkëputur nga libri: "Në mbrojtje të Profetit tonë"

Përshtati: Unejs Murati

VLERA E DY VARGJEVE TË FUNDIT TË KAPTINËS BEKARE

Allahu i Lartësuar thotë: "I Dërguari i besoi asaj që iu shpall prej Zotit të tij, e ashtu edhe besimtarët. Secili i besoi Allahut, engjëjve të Tij, shpalljeve të Tij, të Dërguarve të Tij. Ne nuk bëjmë dallim në asnjërin nga të Dërguarit e Tij dhe thanë: "Iu përgjigjëm thirrjes dhe respektuam urdhrin. Kërkojmë faljen tënde o Zoti ynë! Vetëm te Ti është ardhmëria jonë." Allahu nuk e obligon asnjë njeri përtej mundësisë së tij, atij (njeriut) i takon ajo që e fitoi dhe atij i bie ajo (e keqe) që e meritoi. "Zoti ynë, mos na dëno nëse harrojmë ose gabojmë! Zoti ynë, mos na ngarko neve barrë të rëndë siç i ngarkove ata që ishin para nesh! Zoti ynë, mos na ngarko me atë për të cilën ne nuk kemi fuqi! Na i shlyej mëkatet, na i mbulo të këqijat, na mëshiro. Ti je mbrojtësi ynë, na ndihmo kundër popullit jobesimtar!"

Bekare: 285-286

VLERA E KËTYRE DY VARGJEVE

Këto dy vargje kanë vlerë të madhe, siç tregon Pejgamberi sal-**l**Alahu alejhi ve sel-lem në fjalët e tij të ndershme. Për vlerën e madhe të këtyre dy vargjeve tregon vendi dhe koha e zbritjes së tyre dhe gjithashtu edhe mënyra se si iu dhanë Muhamedit sal-**l**Alahu alejhi ve sel-lem. Në të njëjtën kohë, vlerën e tyre e bëjnë edhe më të madhe hadithet që tregojnë shpërblimin për atë që i lexon këto dy citate.

1. Vendi dhe koha kur iu shpallën këto vargje Muhamedit sal-**l**Alahu alejhi ve sel-lem

Ajo që tregon vlerën e këtyre dy vargjeve është se të Dërguarit të Allahut iu shpallën natën e Miraxhit të Sidretul-Munteha, në një kohë të vlefshme dhe vend të lartë, afër Allahut, qoftë i madhëruar. Nuk ka dyshim se veçimi i këtyre dy citateve, që t'i jepen në këtë vend dhe kohë të ndershme, tregon për vlerën e madhe që kanë

ato. Imam Muslimi transmeton në koleksionin e tij autentik nga Abdullah ibën Mes'udi, Allahu qoftë i kënaqur me të, se ka thënë:

"Kur i Dërguari i Allahut është ngritur në qiell, përfundoi tek Sidretul-Munteha, e cila është në qiellin e gjashtë. Tek ajo përfundon çfarë ngrihet nga toka dhe aty merret e ngrihet larg. Aty ndalet çfarë zbritet nga lart e merret prej aty e zbritet në tokë. Allahu thotë: **"Atëherë kur Sidrën e mbuloj çka e mbuloj."** Nexhm: 16

Tha: **"Mbulojë nga ari."** Pastaj shtoi: "Aty iu dhanë Pejgamberit sal-**l**Alahu alejhi ve sel-lem tri gjëra: pesë kohët e namazit, dy citatet e fundit të sures El Bekare dhe falja e mëkateve të mëdha për atë që nuk i bën shok Allahut nga umeti i tij." [1]

2. Zbritja e tyre nga një thesar nën Arshin e Allahut të Lartësuar

Dhënia e këtyre dy citateve Pejgamberit sal-**l**Alahu alejhi ve sel-lem nga një thesar i cili gjendet nën Arshin e Allahut, nga i cili nuk i është

[1] Sahih Muslim me sqarim të imam Neveviut (Dar el-fikr, botim i tretë, 3\ 2-3). Te fjala e tij: "E cila gjendet në qiellin e gjashtë...", imam Neveviu thotë: "Kështu ka ardhur puthuajse në të gjithë librat e hadithit, qielli i gjashtë, mirëpo kanë ardhur transmetime të tjera nga Enesi, Allahu qoftë i kënaqur me të, se Sidretul Munteha është mbi qiellin e shtatë. Kadij Ijadi, Allahu e mëshiroftë, thotë: "Se ajo është në qiellin e shtatë është më afër së vërtetës dhe ky mendim është mendimi i shumicës së dijetarëve, me këtë përshtatet edhe domethënia e kësaj fjale "Sidreja përfundimtare". Thashë (imam Neveviu): "Mund t'i bashkojmë këto dy mendime e të thuhet se fillimi apo baza e kësaj Sidre është në qiellin e gjashtë, ndërsa pjesa më e madhe e saj është në qiellin e shtatë sepse dihet se ajo gjendet në kulminacion të lartësisë...", përfundon fjala e imam Neveviut.

Ndërsa fjala e tij: "Falja e mëkateve të mëdha për atë që nuk i bën shok Allahut" do të thotë se nuk qëndron përgjithmonë në xhehenem, për dallim nga politeistët, mushrikët, dhe jo se nuk dënohen që në esencë, sepse argumentet e shariatit dhe konsensusi i Ehlul Sunnetit dhe Xhematit vërtetën dënimin e disa mëkatarëve muslimanë (Sherh En-Nevevi, vëllimi 3, faqe 2). Kjo është si fjala e Allahut të Lartësuar: "Eshtë e vërtetë se Allahu nuk fal (mëkatin) t'i bëhet Atij shok, e pos këtij (mëkati), të tjerat i fal atij që dëshiron. Ai që i përshkruan shok Allahut, ai ka humbur dhe bërë një largim të madh (prej së vërtetës)." Pra, Allahu i fal mëkatet e vogla dhe të mëdha atij që pendohet, ndërsa ai që nuk pendohet nga mëkatet e mëdha, ai është në dëshirën e Allahut; nëse do, ia fal e nëse do, e dënon.

dhënë askujt asgjë dhe nuk do t'i jepet askujt tjetër ndonjëherë, pa dyshim se tregon për vlerën e madhe të këtyre dy citeve.

Transmetohet me zinxhir të saktë nga Hudhejfe ibënul-Jemani, Allahu qoftë i kënaqur me të, se i Dërguari i Allahut sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë:

"Jemi veçuar nga të tjerët^[2] me tri gjëra: është bërë toka e tëra për ne vendfalje^[3] dhe dheu i saj i pastër, rreshtat e namazlive janë bërë si rreshtat e melaikeve dhe më janë dhënë këto citate, fundi i kaptinës Bekare, nga një thesar nën Arsh, nga i cili nuk i është dhënë askujt para meje dhe as nuk do t'i jepet pas meje."^[4]

Pa dyshim se nxjerrja e këtyre dy citeve nga ky thesar, i cili gjendet nën Arshin e Allahut të Lartësuar, tregon për vlerën e madhe që kanë këto dy vargje dhe për kujdesin e madh që është ushtruar ndaj tyre, duke i veçuar kështu nga citatat e tjera të Kur'anit Fisnik.

3. Zbritja e tyre nga një libër të cilin Allahu i Madhëruar e ka shkruar para se të krijonte qiejt dhe tokën

Gjithashtu ajo që i veçoi këto dy citate është fakti se ato janë zbritur nga një libër të cilin Allahu e shkroi para se të krijonte qiejt e tokën.

Transmetohet nga Nu'man ibën Beshiri, Allahu qoftë i kënaqur me të, se i Dërguari i Allahut sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë:

"Allahu i Madhëruar ka shkruar një libër dy mijë vjet para se të krijonte qiejt e tokën. Zbriti nga ai libër dy citate me të cilat e përmylli suren El-Bekare. Nuk lexohen në ndonjë shtëpi tri net e të mund t'i afrohet shejtani."^[5]

4. Dërgimi i melekut që nuk kishte zbritur në tokë asnjëherë

Nga vlerat që gëzojnë këto dy citateve është edhe

fakti se Allahu dërgoi një melek nga melaiket e Tij të ndershme, i cili nuk kishte zbritur në tokë kurrë më herët. Ai ka zbritur nga një derë prej dyerve të qiellit, e cila nuk ishte hapur kurrë më herët. I shkoi Muhamedit sal-lallahu alejhi ve sel-lem dhe e përgëzoi me to duke i thënë se ato janë dritë që nuk i janë dhënë asnjë Pejgamberi para tij dhe se për çdo shkronjë që lexon do t'i jepet shpërblim. Këtë e mbështesim në atë që transmeton Muslimi nga Ibën Abasi, Allahu qoftë i kënaqur me të, i cili thotë:

"Derisa ishte Xhibrili ulur tek i Dërguari i Allahut sal-lallahu alejhi ve sel-lem, dëgjoi një zë lart mbi të, e ngriti kokën dhe tha: "Kjo është një derë e qiellit, u hap sot dhe nuk do të hapet kurrë më përveçse sot." Pastaj tha: "Përgëzohu me dy dritat që t'u dhanë, të cilat nuk i janë dhënë asnjë Pejgamberi para teje. Ato dy drita janë Fatihatul-kitab (Fatihë) dhe fundi i kaptinës Bekare; nuk lexon asnjë shkronjë nga ato që mos të të jepet shpërblimi."^[6]

Ky hadith i ndershëm e sqaroi vlerën e këtyre citeve në disa pika:

- a) Këto dy citate u përmendën së bashku me Fatihanë, që është surja më e vlefshme e Kur'anit dhe pa dyshim që kjo tregon për vlerën e tyre.
- b) Kur u përgëzua Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem, u hap një derë qiellore, e cila nuk ishte hapur kurrë më herët. Kjo tregon për veçorinë e asaj që zbritet.
- c) Zbritja e melekut nga qielli, detyra e të cilit ishte përgëzimi i të Dërguarit sal-lallahu alejhi ve sel-lem, tregon vlerën e këtyre dy citeve sepse përgëzimi me diçka tregon vlerën e tij, pozitën e lartë të tij dhe gjithashtu gëzimin e madh që ndien i përgëzuari.
- d) Cilësimi i saj dhe i Fatihës si dy drita është cilësim i madh, që do të thotë se çdonjëra prej tyre i bën dritë lexuesit të saj dhe e udhëzon

[2] Këtu ka për qëllim popujt që ishin para nesh, d.m.th. popujt e Pejgamberëve të tjerë para Muhamedit sal-lallahu alejhi ve sel-lem (sh.p).

[3] Domethënë se te popujt e mëhershëm vendi për falje ishte i caktuar dhe nuk e kishin të lejuar të faleshin aty ku i zinte koha e namazit, ndërsa për ne muslimanët Allahu ka bërë që e tërë toka të jetë vendfalje (sh.p).

[4] Transmeton imam Ahmedi (5\883), imam Bejhekiu në sunenin e tij (1\213) dhe imam Nesaiu në "Sunen el-kubra" (7\260, nr i hadithit 7968). Dijetari Albani e ka cilësuar të saktë në "Koleksionin e haditheve autentike" (3\471).

[5] Transmeton imam Ahmedi (4\273), imam Tirmidhiu në "El Xhami" (5\159-160) dhe ka thënë: "Hadith hasen garbi". Hakimi në "Mustedrek" dhe ka thënë: "Sahihul-isnad". E ka aprovuar imam Dhehebiu. Dijetari Albani e ka cilësuar të saktë në Sahih-Tirmidhi.

[6] Transmeton imam Muslimi (2\458) me sqarim të imam Neveviut, nr. i hadithit 247.

rrugës së drejtë ashtu siç udhëzoi drita me shkëlqimin e saj. Pa dyshim se këto drita e udhëzojnë atë që i lexon këto citate drejt ndjekjes së rrugës së Pejgamberit sal-lAlahu alejhi ve sel-lem dhe rrugës së shokëve të tij, Allahu qoftë i kënaqur me ta, drejt besimit të vërtetë dhe Islamit të sinqertë për Allahun e Madhëruar, drejt nënshtrimit ndaj Tij, kërkimit të faljes së mëkateve dhe dhurimit të mëshirës nga Ai. Këto drita i udhëzojnë njerëzit drejt kthimit tek Allahu në çdo gjendje të tyre.^[7]

e) Meleku për to dhe për Fatihanë i tha: "Të janë dhënë ty e nuk i janë dhënë asnjë Pejgamberi para teje." Kjo do të thotë se nuk i është dhënë shpërblimi i veçantë i tyre, sepse ndryshe nuk do të kishte kuptim, duke qenë se edhe citatet e tjera nuk u janë dhënë Pejgamberëve të tjerë përveç Muhamedit sal-lAlahu alejhi ve sel-lem. Kjo tregon për vlerën e madhe të tyre, që shpërblimet e veçanta që kanë këto dy citate nuk i janë dhënë asnjë Pejgamberi para Muhamedit sal-lAlahu alejhi ve sel-lem.^[8]

f) Faza "nuk lexon asnjë shkronjë nga to veçse do të të jepet shpërblimi" ka dy kuptime:

1. Nëse fjala harf, shkronjë, ka kuptimin e fjalisë, atëherë kuptimi i hadithit është: Nuk lexon ndonjë fjalë nga këto dy citate e të mos të të jepet ajo që përmban kjo fjalë. Nëse është lutje, do të kesh përgjigjen e saj dhe nëse është falënderim për Allahun, do të të jepet shpërblimi.

2. Nëse fjala shkronjë ka kuptimin e shkronjave të alfabetit, atëherë kuptimi i hadithit është: Shpërblimet që janë për çdo shkronjë të Kur'anit të këto dy citate janë sigurisht të fituara sepse përndryshe nuk do të kishte ndonjë dallim nga cilido citat tjetër i Kur'anit, pasi, siç e dimë, për çdo shkronjë të Kur'anit shpërblimi është dhjetë-

fish.^[9]

Nuk ka ndonjë pengesë që këto dy kuptime të jenë të sakta.

5. Shpërblimi i lexuesit të këtyre dy citateve

Për vlerën e këtyre dy citateve tregon edhe hadithi që transmeton Buhariu në koleksionin e tij autentik nga Ebu Mes'ud Ukbete ibën Amër el Ensarij el Bedrij, se i Dërguari i Allahut sal-lAlahu alejhi ve sel-lem ka thënë:

"Kush i lexon dy citatet e fundit të kaptinës Bekare në një natë, do t'i mjaftojnë."^[10]

Lajmërimi i Pejgamberit sal-lAlahu alejhi ve sel-lem, se kush i lexon këto dy citate në një natë, do t'i mjaftojnë, tregon për vlerën e madhe që gëzojnë këto dy citate. Mirëpo Muhamedi sal-lAlahu alejhi ve sel-lem nuk ka veçuar se për çfarë i mjaftojnë këto dy citate, por i ka lënë të përgjithshme. Për këtë arsye, shohim se komentuesit e haditheve kanë dhënë mundin e tyre që të tregojnë se cila është ajo gjë që do t'i mjaftojë lexuesit, nëse i lexon këto dy citate.

Rezultati i të gjitha mendimeve është se i mjaftojnë duke e ruajtur nga çdo e keqe e shejtanit dhe ndihmësve e pasuesve të tij nga xhinët dhe njerëzit. Gjithashtu i mjafton edhe shpërblimi i përgatitur për lexuesin e tyre dhe pranimit i lutjes së tij. Ato i mjaftojnë edhe në çështje të bindjes sepse përfshijnë besimin dhe veprat në mënyrë të përgjithshme.^[11] Pra, këto dy citate i përmbledhin të gjitha këto, me lejen e Allahut të Madhëruar, e nuk ka kufi për dhuntitë dhe të mirat e Allahut, qoftë i lartësuar.

Vijon

Marrë nga Revista e Universitetit Islamik të Medinës nr. 132, 1426 h. Shkroi Dr. Imad Ibën Zuhejr Hafidh Profesori në Fakultetin e Kur'anit në UI të Medinës Përshtati: Fidan Xhelili

[7] Shiko: "El-Mufhim lima eshkele min sahih Muslim" (2\434), autor Hafidh Ebul Abas Ahmed ibën Omer ibën Ibrahim El-Kurtubi.

[8] Shiko: "Ikmal ikmal el-mu'lim" (2\422), Ebu Abdilah Muhamed ibën Halefe El-Veshtani.

[9] Po aty.

[10] Buhariu, libri (66), "Fadail-Kur'an", kapitulli (10), "Vlera e kaptinës Bekare, nr. i hadithit (5009). Muslimi në kapitullin "Vlera e kaptinës El-Fatiha dhe fundi i kaptinës El Bekare", nr. i hadithit (248-249).

[11] Shiko: "Sherh En-Nevevi Sahihut të Muslimit" (2\458), "Fet'hul barj" (9\56), "Irshadus-sarij (7\46) etj.

VARGU I GJURMËVE AUTENTIKE NGA SAHABËT DHE TABIINËT (2)

[11] – Transmetohet nga es-Saib ibën Jezidi, i cili ka thënë: "Gjersa isha në këmbë në xhami, papritmas më gjuajti një njeri me guralecë. Kur shikova, ishte Umer ibnul-Hatabi, i cili më tha: "Shko dhe më sill ata dy njerëz." Kur i solla ata të dy, ai i pyeti: "Kush jeni ju", apo: "Prej nga jeni?" Ata të dy thanë: "Nga banorët e Taifit." Ai u tha: "Sikur të kishit qenë banorë të këtij vendi, do t'ju kisha rrahur. Si e ngrini zërin në xhaminë e të Dërguarit të Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem?"

Ether autentik, e transmeton Buhariu në Sahihun e tij (nr.470) kaptina e namazit (83), kapitulli: Ngritja e zërit në xhami.

[12] – El-Humejdi thotë: "Një ditë Shafiu citoi një hadith dhe një njeri i tha: "Po ti, a je i këtij mendimi, o Ebu Abdullah?" Ai (Shafiu) u drodh dhe tha: "O ti njeri! A mos më njeh mua si të krishterë?! A mos më ke parë duke dalë nga manastiri?! A mos më ke parë ndonjëherë duke mbajtur kambanën? A është e mundur të transmetoj ndonjë hadith nga i Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem e unë të mos punoj me të (apo them që të mos punohet me të)?!"

Ether Autentik, e transmeton Bejhakui në "Menakibush-Shafi'ij" (1/174), Ebu Nuajmi në "Dhikru Ahbari Asbahan" (1/183) dhe në

"Hiljetul-Evlia" (9/106) me rrugë të ndryshme nga Humejdi.

[13] – Transmetohet nga Tarik ibën Shihabi, i cili ka thënë: "Çifutët i thanë Umer Ibnul-Hatabit: "Ju në librin tuaj lexoni një ajet që sikur të na kishte zbritur neve çifutëve, ditën e zbritjes së tij do ta kishim shndërruar në festë." Umeri i pyeti: "E cili ajet është ai?"

Ata thanë: "**Këtë ditë Unë e përsosa fenë tuaj për ju, plotësova Mirësinë Time mbi ju dhe zgjodha për ju Islamin fe.**" Maideh: 3

Umeri ua ktheu: "Pasha Allahun, unë e di ditën dhe kohën kur i është shpallur të Dërguarit të Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem. I është shpallur mbrëmjen e Arafatit, në ditën e xhuma."

Ether autentik, e transmeton Buhariu (45, 4407, 4606, 7278), Muslimi (3017), Nesaiu në el-Kubra (6/332-333/11137) dhe Tirmidhiu (3043).

Dobi: Umeri me këto fjalë u ka treguar çifutëve se ditën kur ka zbritur ky ajet Allahu e ka bërë ditë festë për të gjithë muslimanët, siç transmetohet në një hadith të saktë në librat e Suneneve nga Ukbete ibën Amiri, se Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë: "Dita e Arafatit, dita e therjes (së kurbaneve) dhe ditët e Teshrikut janë festa jonë, e pasuesve të Islamit, dhe ato ditë janë ditët

e ngrënies dhe pirjes." Nga Fet'hul-Bari me koment të Ibën Rexhebit (1/158-159).

[14] – Abdullah ibën Mesudi, Allahu qoftë i kënaqur me të, ka thënë: "Njerëzit do të jenë në mirësi derisa marrin dijen nga shokët e Muhamedit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem dhe nga të mëdhenjtë e tyre. E kur vjen dija nga të vegjlit e tyre, shkatërrohen."

Ether autentik, e transmeton Abdullah ibën Mubareku në ez-Zuhd (nr. 815), AbdurRezzaku në Musannefin e tij (11/249, 257/20446, 20483), Hatib el-Bagdadi në "el-Fekihu vel-Mutefekkih" (2/155/776) dhe shumë e shumë të tjerë.

Dobi: Me "të vegjlit" është fjala për ata që shpikin në fe apo ata të cilët nuk kanë dije. Këtë e ka aprovuar Tartushi në "el-Havadithu vel-Bidau" fq.80, dhe të këtij mendimi janë një numër i madh dijetarësh, prej tyre Hatib el-Bagdadi, Ibën Kutejbe dhe të tjerët.

[15] – Rrëfëhet nga Sead ibën Ebi Vekasi se për fjalën e Allahut azze ve xhel: "*Ne të sjellim ty (o Muhamed) tregimet më të mira me anë të shpalljeve tona*"^[1] ka thënë: "Allahu ia ka zbritur Kur'anin të Dërguarit të Tij sal-lAllahu alejhi ve sel-lem e ai ua lexoi atyre (shokëve të tij) një kohë. Ata thanë: "O i Dërguar i Allahu, sikur të na kishe cituar diçka nga tregimet!" Atëherë Allahu i Lartësuar shpalli: "**Elif-lam-ra. Këto janë vargjet e librit të qartë.**"^[2] **Pa dyshim që Ne e zbritëm atë Kuran arabisht.**" Jusuf: ajeti 1-2 dhe vazhdoi t'ju lexojë një copë kohë. Pastaj thanë: "O i Dërguar i Allahu; sikur të na kishe folur për diçka!" Atëherë Allahu shpalli: "**Allahu zbriti fjalën më të shkëlqyer, një libër (këtë Kuran) pjesët e të cilit i përngjasin njëra-tjetrës në mirësi e vërtetësi.**" Zumer: 23. Të gjitha këto ajete porosisin me Kur'an.

Hal-ladi (një nga transmetuesit e senedit) ka shtuar: "Disa të tjerë më kanë shtuar: "(Sahabët) Kanë thënë: "O i Dërguar i Allahu; sikur të na kishe përkujtuar me diçka!" Atëherë Allahu shpalli: "**A nuk ka ardhur koha për ata që besojnë që zemrat e tyre të ndikohen nga mesazhi përkujtues i Allahut (nga Kurani) dhe nga ajo që u është shpallur nga e vërteta (dhe të përkujtojnë Allahun)?"**" Hadid: 16

Etheri është hasen, e transmeton Bezzari, siç gjendet në "el-Bahru ez-Zehhar" (nr. 1152, 1153), Ibën Ebi Hatim në Tefsirin e tij (7/2099-3000/11323-11325), Ibën Xherir et-Taberi në Tefsirin e tij (12/90), Ibën Hibbani në Sahihun e tij (14/92/6209) dhe të tjerët.

[16] – Transmetohet nga Sulejman Ibën Kajs el-Jeshkurij, i cili ka thënë: "I thashë Xhabir ibën Abdullahut: "Nëse udhëheqësi ynë është mizor e zullumqar, a të luftoj së bashku me të kundër të devijuarve?" Ai tha: "Po, ai mban përgjegjësinë për atë që është ngarkuar, kurse ju për të tuajën."

Ether autentik, e transmeton Ibën Ebu Shejbeh në Musannefin e tij (12/449-450), Hanbeli në Xhuz-in e tij (nr. 77).

Teksti i këtij etheri është transmetuar përafërsisht i njëjtë edhe nga Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, siç qëndron në Sahihun e Muslimit (1846).

[17] - Transmetohet nga el-Esved ibën Jezidi se ka thënë: "Nuk kam dëgjuar askënd nga shokët e Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, nga ata që ishin në Kufe, duke urdhëruar në agjërimin e ditës së Ashuras, përveç Aliut alejhi selam dhe Ebu Musa el-Eshariut."

E transmeton Ibën Ebu Shejbeh në Musan-

[1] Jusuf: 3.

[2] I cili dallon qartë të ligjshmet dhe të paligjshmet, udhërrëfyes me ligje, udhëzim dhe mirësi.

nefin e tij (2/312/9361,9362), Tajalisiu në Musnedin e tij (nr. 1212), AbduRrezzaku në Musannefin e tij (4/7836) dhe shumë e shumë të tjerë me rrugë të shumta.

Dhe senedi i tij është autentik, siç e ka shpallur Ibën Haxheri në "el-Metalib el-Alijeh" (nr. 1077).

[18] – Transmetohet nga Muxhahidi, Allahu e mëshiroftë, se rreth komentit të fjalës së Allahut të Lartësuar: "**Ai i dhuron urtësi atij që Ai dëshiron**" Bekareh: 269 ka thënë: "(I jep) dije dhe kuptim."

Etherin e transmeton: Ibën Ebu Hatimi në Tefsirin e tij (2/531/2823), Hatib el-Bagdadi në "el-Fekihu vel-Mutefekkih" (1/132, 133), Axhuriu në "Ahlaku el-Ulema" (nr.1), Ibën Xherir et-Taberi në Tefsirin e tij (3/90), Bejhakui në "el-Med'hal" (nr. 270). Hadithi është nxjerrë nga dy rrugë dhe senedi i tij nga Shebabe është autentik.

[19] - Transmetohet nga Xhabir Ibën Abdillahu, Allahu qoftë i kënaqur me të, se rreth komentit të fjalës së Allahut të madhërishtëm: "**Binduni Allahut dhe binduni të Dërguarit dhe atyre që janë prej jush nga udhëheqësit tuaj**" Nisa: 59, ka thënë: "Ata që kuptojnë fenë dhe të mirën."

Ether hasen, e transmeton Ibën Ebu Shejbeh në Musannefin e tij (6/421/32523), Ibën Ebu Hatimi në Tefsirin e tij (3/988/5533), Taberiu në Tefsirin e tij (5/94) dhe të tjerët. Ky ether është transmetuar saktësisht edhe nga Atau në Tefsirin e Taberiu (5/147), tek Hatib el-Bagdadi në "el-Fekihu.." (101), dhe shiko "Sunenu ed-Darimij" (1/297/225).

[3] Ekspertët e shariatit.

[20] – Transmetohet nga Muxhahidi rreth fjalës së Allahut: "**dhe atyre që janë prej jush nga udhëheqësit tuaj**", se ka thënë: "Ata janë fukahatë^[3] dhe dijetarët."

Etheri është autentik, e transmeton Taberiu në Tefsirin e tij (5/94), Axhuriu në "Ahlaku-Ulema" (nr. 6), Ibën Abdul-Berri në "Xhamiu bejanil-Ilmi" (1/768/1418) dhe të tjerët.

*E shkëputur nga libri "Vargu i Gjurmëve Autentike nga Sahabët dhe Tabiinët"
Përshatë: Zejd Haziri*



FEKONDIMI ARTIFICIAL (FËMIJËT E EPRUVETAVE)

Falënderimi i takon Allahut, ndërsa salavatet dhe selamet qofshin mbi të Dërguarin tonë Muhamedin, mbi familjen dhe mbi shokët e tij.

Këshilli i Akademisë Islamike të Fikhut bëri shqyrtimin e studimit të paraqitur nga anëtari i këshillit, Mustafa Ahmed ez-Zerkau, rreth fekondimit artificial apo fëmijëve të epruvetave, një çështje e cila preokupon njerëzit dhe është ndër çështjet më eminente në botë aktualisht. Këshilli bëri diskutimin e arritjeve shkencore në këtë sferë dhe u ndal te arritjet e shkencës dhe teknikës në kohën bashkëkohore në lidhje me mundësimin e lindjes së fëmijëve dhe mposhtjen e shkaqeve të ndryshme të sterilitetit.

Nëpërmjet studimeve të kompletuara që u përmendën, këshillit iu bë e qartë se fekondimi artificial (jo në mënyrë natyrale, i cili bëhet përmes kontaktit seksual të drejtpërdrejtë mes mashkullit dhe femrës) arrihet nëpërmjet njërës nga këto dy metoda themelore:

1- Metoda e fekondimit të brendshëm, e cila bëhet me injektimin e spermës së mashkullit në brendi të organeve të gruas.

2 - Metoda e fekondimit të jashtëm, e cila bëhet me fekondimin mes spermës së mashkullit dhe qelizës vezë të femrës në një epruvetë testuese në laboratorët mjekësore, pastaj qeliza vezë e fekonduar mbillet në mitrën e gruas.

Në të dyja metodat është e domosdoshme që grua të zbulojë trupin e saj në mënyrë që të kryhet ky veprim.

Nëpërmjet studimeve të prezantuara rreth kësaj teme dhe në bazë të provave të dalta nga diskutimet, këshillit iu bë e qartë se format dhe mjetet nëpër të cilat kalon fekondimi artificial i shu-

mimit me metodën e brendshme dhe të jashtme gjithsej janë shtatë. Metoda e fekondimit të brendshëm ka dy forma, kurse metoda e fekondimit të jashtëm ka pesë forma për nga aspekti praktik, duke mos shqyrtuar fillimisht se a janë të lejuara sipas sheriatit apo jo. Këto forma janë:

Fekondimi artificial i brendshëm

Forma e parë

Merret sperma e burrit të martuar dhe pastaj injektohet në brendi të organeve të gruas së tij apo në mitrën e saj, në mënyrë që spermatozoidi të takohet në mënyrë natyrale me qelizën vezë të bashkëshortes së tij. Pastaj bëhet fekondimi dhe më pas ndodh ngjitja e saj në murin e mitrës me lejen e Allahut, si në rastin e marrëdhënies seksuale. Kjo formë përdoret në rastin kur bashkëshorti për ndonjë arsye të caktuar është i paafte të çojë spermën e tij deri në vendin e duhur gjatë marrëdhënies seksuale.

Forma e dytë

Merret sperma e një personi dhe injektohet brenda organeve të bashkëshortes së një burri tjetër, në mënyrë që të ndodhë fekondimi i brendshëm dhe më pas edhe ngjitja e qelizës vezë të fekonduar në murin e mitrës, si në formën e parë. Kjo formë përdoret në rastin kur bashkëshorti është steril dhe sperma merret nga një person tjetër dhe vendoset në mitrën e gruas së tij.

Fekondimi artificial i jashtëm

Forma e tretë

Merret sperma nga bashkëshorti dhe qeliza vezë nga bashkëshortja e tij dhe vendosen në epruvetën e laboratorit mjekësor nën kushte të caktuara fizike, në mënyrë që spermatozoidet e bashkëshortit të fekondohen me qelizën vezë të bashkëshortes së tij në atë epruvetë, pastaj qeliza vezë e fekonduar merret në kohë të përshtatshme dhe transferohet në mitrën e asaj gruaje, që pastaj ajo qelizë e fekonduar të ngjitet në murin e mitrës dhe me këtë krijohet embrioni dhe zhvillohet si çdo foshnjë. Pastaj, në fund të kohës së shtatzënisë natyrale, gruaja lind foshnjën. Ky fëmijë është ai që quhet "fëmijë epruvete", arritje të cilën shkencëtarët kanë arritur ta bëjnë me lehtësimin e Allahut. Nëpërmjet kësaj forme, deri sot kanë lindur një numër fëmijësh meshkuj dhe femra, madje edhe binjakë. Lidhur me këtë kanë informuar gazetatat dhe mjetet e ndryshme të informimit anembanë botës. Kjo formë përdoret kur gruaja është sterile për shkak të mbylljes së kanalit, i cili bën lidhjen mes vezorit dhe mitrës së saj.

Forma e katërt

Në epruvetën e laboratorit fekondimi i jashtëm bëhet në mes spermës së marrë nga bashkëshorti dhe qelizës vezë të marrë nga një grua e cila nuk është bashkëshorte e tij (këtë grua e quajnë dhuruese), pastaj qeliza e fekonduar mbillet në mitrën e bashkëshortes së këtij burri. Kjo metodë përdoret në rastin kur vezori i bashkëshortes është hequr apo nuk funksionon, por mitra e saj është e shëndoshë dhe qeliza vezë e fekonduar mund të ngjitet në të.

Forma e pestë

Në epruvetën e laboratorit fekondimi i jashtëm bëhet mes spermës së një personi dhe vezës së një gruaje e cila nuk është bashkëshorte e tij (të dy këta i quajnë dhurues), pastaj qeliza vezë e fekonduar mbillet në mitrën e një gruaje tjetër. Kjo

formë përdoret në rastin kur gruaja e martuar në të cilën është mbjellë qeliza vezë e fekonduar është sterile për shkak të prishjes së vezorit, por mitra e saj është e shëndoshë dhe gjithashtu bashkëshorti i saj është steril dhe në të njëjtën kohë këta të dy dëshirojnë të kenë fëmijë.

Forma e gjashtë

Në epruvetë bëhet fekondimi i jashtëm mes farës së dy bashkëshortëve, pastaj qeliza vezë e fekonduar mbillet në mitrën e një gruaje tjetër, e cila vullnetarisht merr përsipër mbartjen e shtatzënisë. Kjo formë përdoret në rastin kur gruaja s'ka mundësi të jetë shtatzënë për shkak të mitrës së saj të prishur apo të hequr, por vezori i saj është i shëndoshë dhe produktiv ose kur kjo grua nuk ka dëshirë të ngelë shtatzënë për shkak të komoditetit të jetës së saj dhe një grua tjetër del vullnetare ta mbartë shtatzëninë në vend të saj.

Forma e shtatë

Është si forma e gjashtë, nëse gruaja që vullnetarisht ka marrë përsipër mbartjen e shtatzënisë është gruaja e dytë e burrit të cilit i është marrë spermatozoidi dhe kështu gruaja e tij e dytë pranon që vullnetarisht ta mbartë qelizën vezë të fekonduar në vend të gruas së tij të parë.

Kjo formë nuk praktikohet në vendet ligjet e të cilave e ndalojnë poligaminë, por praktikohet në vendet që e lejojnë poligaminë.

Këto janë format e fekondimit artificial që shkencëtarët kanë arritur t'i bëjnë për të mjekuar shkaqet që pengojnë shtatzëninë.

Këshilli i akademisë i shqyrtoi informatat që janë publikuar dhe tregojnë se në realitet këto arritje shkencore janë duke u praktikuar në Evropë dhe Amerikë për objektiva të ndryshme; disa prej tyre për përfitime materiale, disa nën titullin "zbukurimi i llojit njerëzor", disa për shkak të dëshirës së të qenët nënë nga gratë e pamartuara apo nga gratë e martuara që nuk ngelin shtatzënë për arsye që ekzistojnë tek ato apo të bashkëshortët e tyre. Po ashtu, këshilli shqyrtoi informatat për themelimin e të ashtuquajturave

"banka të farës njerëzore", në të cilat depozitohen spermatozoidet e meshkujve dhe në formë teknike arrihet që këto spermatozoide të jenë të gatshme për fekondim për një kohë të gjatë. Në disa vende të botës perëndimore, këto spermatozoide merren nga meshkuj të caktuar apo edhe nga meshkuj të pacaktuar, vullnetarisht apo edhe me kompensim financiar.

Shqyrtimi ligjor nëpërmjet thjerrëzave të shariatit islamik

Këshilli i Akademisë Islamike të Fikhut, pas shqyrtimit të njohurive të besueshme të mbledhura dhe asaj që është shkruar dhe publikuar lidhje me këtë çështje si dhe në bazë të rregullave të shariatit islamik dhe objektivave të tij lidhur me njohjen e dispozitave mbi këto forma të prezantuara, arriti përfundimin vijues të detajuar:

Së pari, disa dispozita të përgjithshme

a - Zbulimi i trupit të femrës muslimane para personave që e ndalon sheriati nuk lejohet asesi, përveçse për qëllimet për të cilat sheriati e bën të lejuar zbulimin.

b - Nevoja që gruaja ka për mjekimin nga një sëmundje që e mundon apo për mjekimin nga ndonjë rast i panatyrshëm në trupin e saj, i cili i shkakton trazime, konsiderohet arsye e pranuar nga sheriati dhe i lejohet asaj të zbulohet para të tjerëve për shkak të këtij mjekimi. Pra, zbulimi i trupit të femrës kushtëzohet në bazë të domosdoshmërisë.

c - Çdo herë që gruaja zbulohet për ndonjë qëllim që e pranon sheriati para personave që nuk lejohet, atëherë është e obliguar që mjeku të jetë femër muslimane, nëse ka mundësi, nëse jo, atëherë femër jomuslimane. Por nëse as kjo nuk është e mundur, merret në konsideratë mjeku musliman dhe nëse as kjo s'ka mundësi, atëherë edhe mjeku jomusliman. Pra, sipas kësaj radhitjeje.

Nuk lejohet që mjeku të vetmohet me gruan të cilën mjekon pa praninë e bashkëshortit të saj ose të një gruaje tjetër.

Së dyti, dispozita mbi fekondimin artificial

1- Nevoja e gruas e cila nuk mund të ngelë shtatzënë dhe nevoja e bashkëshortit të saj që këta të dy të lindin fëmijë konsiderohet arsye e pranuar nga sheriati, arsye e cila e lejon mjekimin me metodat e lejuara të fekondimit artificial.

2- Forma e parë (nëpërmjet së cilës merret sperma e bashkëshortit dhe injektohet në mitrën e gruas së tij me metodën e fekondimit të brendshëm) është formë e lejuar nga sheriati sipas kushteve të përgjithshme të lartpërmendura. Kjo bëhet pasi të jetë konfirmuar nevoja e gruas për këtë proces me qëllim që të ngelë shtatzënë.

3- Forma e tretë (nëpërmjet së cilës merren spermatozoidet mashkullore dhe femërore nga burri dhe gruaja, të cilët janë bashkëshortë, pastaj bëhet fekondomi i jashtëm i qelizave në epruvetën e testit dhe më pas qeliza e fekonduar mbillet në mitrën e kësaj gruaje) parimisht është e pranuar nga vështrimi shariatik, por kjo formë nuk shpëton nga gjërat që sjellin dyshime për shkak të përzierjeve dhe ngatërimeve që e shoqërojnë dhe e rrethojnë atë. Prandaj kjo formë duhet të përdoret vetëm në raste të domosdoshme dhe pasi të jenë plotësuar kushtet e lartpërmendura.

4- Në këto dy raste të lejuara, akademia arrin në përfundimin se fëmija i lindur merr përkatësinë e bashkëshortëve nga të cilët janë marrë qelizat vezë dhe pastaj përkatësinë e pason trashëgimia si dhe të drejtat e tjera. Pra, me rastin e konfirmimit të përkatësisë së foshnjës konformohet edhe trashëgimia edhe dispozitat e tjera mes fëmijës dhe atij që i përket ai fëmijë.

5- Sa u përket formave të tjera të fekondimit artificial, që u sqaruan më parë, të gjitha janë të ndaluara në shariatin islamik dhe nuk ekziston asnjë mundësi që ato të lejohen, pasi spermatozoidet dhe qelizat vezë nuk janë të dy bashkëshortëve.

*Shkëputur nga libri "Fikhu-Nevasil" të Muhamed Xhizanit
Përshtati: Jeton Bozhilani*

ASHTU SI JE ME ROBËRIT E ALLAHUT, ASHTU ALLAHU ËSHTË ME TY

Muhamedi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem thotë: "Me të vërtetë, Allahu i mëshiron të mëshirshmit prej robërve të Vet."

Buhariu

- *Shpërblimi i së mirës është veçse e mira. Kush i mëshiron krijesat, atë e mëshiron Krijuesi*

I Dërguari sal-lAllahu alejhi ve sel-lem thotë: "Të mëshirshmit i mëshiron Mëshiruesi. Mëshironi ata që janë në tokë, ju mëshiron Ai që është mbi qiell." Tirmidhiu, Sahihul-xhami', nr. 5835.

- *Shpërblimi sipas veprës*

Allahu i trajton njerëzit ashtu si njeriu i trajton njerëzit e tjerë, prandaj trajtoj robërit e Allahut me atë që dëshiron të të trajtojë Allahu ty. Allahu thotë:

"Nëse nuk merrni masa, nuk ua vëni veshin dhe i falni, ta dini se edhe Allahu është falës i mëkateve, mëshirues." Tegabun: 14

Gjithashtu, Allahu thotë:

"Po le t'ua falin (gabimin) dhe mos t'ua zënë për të madhe. A nuk dëshironi që Allahu t'u falë ju? Allahu mëshiron dhe falë shumë." Nur: 22

- *Kujdesu t'ua lehtësosh njerëzve vështirësitë, që Allahu të ta lehtësojë ty*

Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem thotë: "Kush i heq një brengë muslimanit, Allahu ia heq atij një brengë prej brengave të Ditës së Kiametit." Buhariu Gjithashtu thotë: "Kush e shpëton një të brengosur (ia largon brengat), Allahu ia largon atij një brengë prej brengave të Ditës së Kiametit." Ahmedi, Sahihul-xhami', nr. 6577.

- *Ndihmoji njerëzit në nevojat e tyre, do të gjesh ndihmën prej Allahut*

Muhamedi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem thotë: "Allahu e ndihmon robin përderisa robi e ndihmon vëllanë e vet." Dhe: "Kush e ndihmon vëllanë e vet, Allahu e ndihmon atë." Muslimi

- *Të jesh për nevojtarët i lehtë, që Allahu të ta lehtësojë ty*

Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem thotë: "Kush ia lehtëson dikujt një çështje që i është vështirësuar, Allahu ia lehtëson atij në këtë botë dhe në ahiret (botën e ardhshme)." Muslimi

Gjithashtu thotë: "Ishte një tregtar para jush (para umetit të Muhamedit), i cili u jepte njerëzve hua. U thoshte djemve të vet: "Nëse shihni dikë në vështirësi (që s'ka mundësi për ta kthyer në atë moment), faleni, se ndoshta Allahu na fal ne." Dhe Allahu e fal atë." Buhariu

- *Nëse sillesh butësisht me robërit e Allahut, do të të përshijë lutja e Muhamedit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem: "O Allahu im, kush sillet butësisht me umetin tim, sillu butësisht me të! Kush sillet ashpërsisht me ta, sillu ashpërsisht me të!"* Ahmedi, hadith autentik.

Gjithashtu thotë: "Allahu është i butë dhe e do butësinë dhe jep nëpërmjet butësisë çka nuk jep nëpërmjet vrazhdësisë." Muslimi

Në një vend tjetër thotë: "Kujt i është marrë butësia, i është marrë mirësia." Muslimi

- *Mbuloji të metat e njerëzve, Allahu të t'i mbulojë ty*
Muhamedi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem thotë: "Kush ia mbulon një të metë vëllait të vet, Allahu ia mbulon atij në dunja dhe ahiret." Muslimi

Gjithashtu thotë: "Kush e mbulon turpin e vëllait të vet musliman, Allahu ia mbulon turpin e tij Ditën e Kiametit." Sahih Ibën Maxheh, 2063

- *Pakësoja vëllait tënd gabimet, Allahu do t'i pakësojë gabimet e tua*

I Dërguari sal-lAllahu alejhi ve sel-lem thotë: "Kush ia pakëson gabimet vëllait të vet, Allahu ia pakëson atij." Sahih Ebu Davudi, 3460.

Pra, ashtu siç je për robërit e Allahut, ashtu Allahu është për ty. E, ti zgjidh për vete se si do që të të trajtojë Allahu ty.

- *Ki kujdes! Mos i dëno njerëzit, që Allahu mos të të dënojë ty*

Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem thotë: "Al-

lahu i dënon ata që i dënojnë njerëzit në dunja." Muslimi

Allahu i madhërishtëm thotë: "**Përkujtoni kur u shpëtua prej popullit të faraonit, nga i cili shijuat dënimin më të hidhur.**" Bekare: 49

Dhe thotë: "... e **Ditën e Kiametit (u thuhet engjëjve): "Ihtarët e faraonit futini në dënimin më të rëndë."** Gafir: 46

- *Ki kujdes që robërve të Allahut të mos ua ngushtosh punët e të të përfshijë lutja e Muhamedit sal-Allahua alejhi ve sel-lem: "O Allahu im, kujt i është dhënë diçka në dorë prej çështjeve të umetit tim (muslimanëve) e ua ka vështirësuar punët atyre, vështirësoja atij! Kush ua lehtëson atyre, lehtësoja atij!" Muslimi*

- *Mos i mundo muslimanët duke ndjekur të metat e tyre*

Pejgamberi sal-Allahua alejhi ve sel-lem thotë: "Kush i ndjek të metat e vëllait të vet, Allahu do t'i ndjekë të metat e tij. E, kujt ia ndjek Allahu të metat e tij, do ta zbulojë atë edhe nëse mbyllet në shtëpi." Tirmidhiu, Sahihul-xhami nr. 7984

Dhe thotë: "Kush i zbulon të metat e vëllait të vet musliman, Allahu ia zbulon të metat atij derisa t'ia shfaqë edhe në shtëpi të tij." Sahih Ibën Maxheh 2536

- *Mos u bë i pamëshirshëm ndaj njerëzve, sepse i Dërguari sal-Allahua alejhi ve sel-lem thotë: "Kush nuk i mëshiron njerëzit, atë nuk e mëshiron Allahu." Muslimi*

Dhe thotë: "Nuk i merret mëshira (rahmeti) vetëm se fatiut." Tirmidhiu, Sahihul-xhami nr. 7467.

Pra, ashtu siç sillësh me robërit e Allahut, po të njëjtën gjë do të gesh tek Allahu.

Imam Ibën Kajimi, Allahu e mëshiroftë, thotë: "Allahu është Bujar dhe e do bujarin prej robërve të Vet. Ai është i Gjithëdijshëm dhe i do të diturit. Ai është i Plotfuqishëm dhe i do guximtarët. Ai është i Bukur dhe e do të bukurën. Ai është i Mëshirshëm dhe i do të mëshirshmit dhe i mëshiron nga robërit e Vet të mëshirshmit. Ai është Mbulues (i të metave) dhe i do ata që ua mbulojnë (të metat) të tjerëve. Ai i fal mëkatet dhe i do ata që ua falin të tjerëve. Ai është i Butë dhe e do të butin prej robërve të Vet dhe e urren fjalën e vrazhdë, të ngurtë, moralin e keq e zërin e ngritur. Ai është i Butë dhe e do butësinë. Ai është i Mirë dhe e do mirësinë dhe të mirët. Ai është

i Drejtë dhe e do drejtësinë. Ai është Pranues i arsyeve dhe i do ata që i pranojnë arsyet nga tjerët. Allahu e shpërblen robin e Vet sipas këtyre cilësive, në bazë të asaj se sa është i pajisur robi me to. Pra, kush nuk merr masa ndaj të tjerëve, Allahu nuk merr ndaj tij; kush ua fal të tjerëve, Allahu ia fal atij; kush ia pranon dikujt ndjesën, Allahu ia pranon atij; kush sillet butësisht me të tjerët, Allahu sillet butësisht me të; kush i mëshiron të tjerët, Allahu e mëshiron atë; kush u bën mirë të tjerëve, Allahu i bën mirë atij; kush u jep të tjerëve (prej pasurisë së tij), Allahu i jep atij; kush u sjell dobi të tjerëve, Allahu i sjell dobi atij; kush ua mbulon të metat të tjerëve, Allahu ia mbulon atij; kush nuk ua vë veshin të tjerëve (dhe ua fal), Allahu ia fal atij; kush i ndjek të metat e të tjerëve, Allahu i ndjek të metat e tij; kush i largon të tjerët nga rruga e Allahut, Allahu e largon atë nga rruga e tij; kush ia ndalon të mirat të tjerëve, Allahu ia ndalon atij; kush përgatit kurth për dikë, Allahu e fut atë në kurth; kush i tradhton të tjerët, tek Allahu ai do të tradhtohet; kush i trajton të tjerët me një cilësi, Allahu do ta trajtojë atë me të njëjtën cilësi në këtë botë dhe në botën tjetër." Pra, Allahu është për robin e Vet ashtu siç është robi për të tjerët; ashtu siç e trajton ti dikë, ashtu do të trajtohesh. Bëhu si të duash, se Allahu është për ty ashtu siç je ti për Allahun dhe për robërit e Tij. Kujdes! Allahu ta lehtësoftë që t'u bësh mirë robërve të Allahut duke praktikuar në këtë mënyrë fjalën e Muhamedit sal-Allahua alejhi ve sel-lem: "Kush mund t'i bëjë dobi vëllait të tij, le t'i bëjë." Muslimi Vepro mirë, se Allahu i do bamirësit. Bëhu i lehtë e i butë për vëllanë tënd, se Muhamedi sal-Allahua alejhi ve sel-lem thotë: "I është ndaluar zjarrit të xhehenemit ta djegë atë që është i lehtë, i butë e i afërt me njerëzit." Ahmedi, Sahihul-xhami nr. 3135. Mos merr masa ndaj tyre, mos ua vër veshin fort fjalëve të tyre, fali ata, që Allahu të mos marrë masa ndaj teje e të t'i falë mëkatet. Allahu nuk e humb shpërblimin e bamirësve.

Lutja e fundit e jona është: Falënderimet qofshin vetëm për Allahun dhe sal-lallahu alejhi ve ala alihi ve sahibihi ve sel-lem!

*Autor: Abdul-Kajum es-Subejbani, mësimmhënë në Universitetin Islamik të Medinës
Përshtati: Fidan Xbelili*

CILËSITË E THIRRËSIT MUSLIMAN

Thirrja në rrugën e Allahut është një ndër veprat më të çmuara dhe më me vlerë.

Këtë më së miri e kuptojmë nga fjalët e Allahut të Madhëruar: **“E kush është në rrugë më të mirë se ai që thërret në rrugën e Allahut, që bën vepra të mira dhe thotë: “Unë jam prej muslimanëve?”** Fus-silet ajeti 33

Ndërsa i Dërguari i Allahut sal-Allahu alejhi ve sel-lem ka thënë: “E kush thërret në rrugë të drejtë (fenë e Allahut), e ka shpërblimin e barabartë me ata që e pasojnë atë duke mos iu munguar (atyre) prej shpërblimit (të tyre) asgjë.” Muslimi

Të jesh thirrës në rrugën e Allahut është një nder i veçantë sepse kjo ka qenë puna e çdo të Dërguari të Allahut. Allahu i Madhëruar në lidhje me të Dërguarin tonë sal-Allahu alejhi ve sel-lem thotë: **“O ti Pejgamber, Ne të dërguam ty dëshmues, lajmëtar, përgëzues e qortues e thirrës në rrugën e Allahut me lejen e Tij dhe pishtar ndriçues.”** Ahzab 46

Thirrësi në rrugën e Allahut është njeriu më i afërt me Allahun, prandaj patjetër duhet të jetë i pajisur me cilësi e norma morale të larta, nëse dëshiron që të ketë sukses në thirrjen e tij.

Në vijim do të cekim disa cilësi që duhet të jenë të pranishme te çdo person që dëshiron të jetë pjesëtar i kësaj thirrjeje të bekuar.

1) Singëriteti

Singëriteti është cilësia më e rëndësishme në çdo vepër, është nga kushtet pa të cilat nuk pranohet vepra. Për këtë arsye, çdo thirrës në rrugën e Allahut duhet të jetë i pajisur me këto cilësi të larta që puna e tij të shpërblehet nga Allahu dhe të jetë e pranuar tek njerëzit. Allahu Fuqiplotë thotë:

“E, ata nuk u urdhëruar me tjetër pos që ta adhuronin Allahun me një adhurim të singërtë ndaj

Tij, që të largohen prej çdo besimi të kotë, ta falin namazin, të japin zekatin, se ajo është feja e drejtë.” Bejjine 5

Ndërsa Pejgamberi sal-Allahu alejhi ve sel-lem ka thënë:

“Veprat shpërblehen sipas qëllimeve dhe se çdo njeriu do t'i takojë ajo që ka bërë niset (ajo që ka pasur për qëllim).” Buhariu, Muslimi.

Shihet qartë nga ajeti kur'anor dhe thënia e të Dërguarit të Allahut sal-Allahu alejhi ve sel-lem se singëriteti në punë (ibadet) është obligim i domosdoshëm, qoftë ajo punë e madhe apo e vogël. Çdo gjë duhet të jetë vetëm për hir të Allahut e jo për ndonjë përfitim material, për ndonjë vend pune apo për lëvdata nga njerëzit. Thirrësi në këtë rrugë duhet të kujtojë gjithmonë shpërblimin e Allahut në botën tjetër e të harrojë shpërblimet dhe lëvdatat e kësaj bote kalimtare. Në mendjen e tij duhet të jenë gjithmonë të pranishme fjalët e Allahut të Madhëruar:

“Unë për këtë nuk kërkoj prej jush ndonjë shpërblim, shpërblimi për mua është vetëm prej Zotit të botëve.” Shuara 109

2) Dituria

Thirrësi në rrugën e Allahut duhet të jetë i pajisur me dituri të mjaftueshme, nëse dëshiron të jetë i suksesshëm në thirrjen e tij. Ai që dëshiron të jetë thirrës në rrugën e Allahut, mirëpo nuk ka dituri, do të bëjë më shumë dëm se dobi. Të pajisurit me dituri është obligim për çdo thirrës musliman. Këtë më së miri e kuptojmë nga fjalët e Allahut të Lartësuar:

“Thuaj: “Kjo është rruga ime, të ftoj drejt Allahut me dituri të plotë, unë dhe çdokush që më pason mua. Larg të metave është Allahu, unë nuk jam nga idhujtarët.” Jusuf 108

Allahu i Lartësuar e urdhëroi të Dërguarin tonë

Muhamedin sal-lAllahu alejhi ve sel-lem me këto fjalë që t'u tregonte jobesimtarëve se kjo është rruga ime, thirrja ime drejt Allahut me dituri dhe argumente të plota, te të cilat nuk ka asnjë dyshim.

Pra, kuptohet qartë nga ky ajet kur'anor se thirrja në rrugën e Allahut duhet të jetë e ndërtuar mbi dituri të plotë dhe argumente të qarta.

Nëse thirrësi musliman është i paditur (xhahil), së pari do ta çojë veten në humbje (dalalet) e pastaj të gjithë ata që e pasojnë atë. Kjo kuptohet qartë nga fjalët e të Dërguarit tonë sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, i cili thotë:

“Allahu nuk e merr diturinë duke e ngritur atë nga njerëzit (dijetarët), mirëpo e ngre diturinë me vdekjen e dijetarëve, derisa të vdesin të gjithë dijetarët dhe në mungesë të

tyre (dijetarëve) njerëzit do t'i marrin të paditurit, injoran-tët, për udhëheqës të tyre.

Do t'i pyesin ata e ata do t'u përgjigjen pa dituri dhe në këtë mënyrë do të jenë të humbur (do të jenë në dalalet) dhe do t'i humbin të tjerët.”

Buhariu, Muslimi.

Ky është rezultati i atij që thërret në rrugën e Allahut pa dituri. Për fat të keq, në ditët tona këta janë të shumtë.

3) Të punuarit me atë që ka mësuar

Thirrësi musliman nuk do të jetë i suksesshëm në thirrjen e tij përderisa nuk vë në praktikë atë që ka mësuar. Kjo njëherazi është prej punëve më të urryera nga Allahu Fuqiptotë, siç kuptohet qartë nga fjalët e Tij: “O ju të cilët keni besuar, përse e thoni atë që nuk e veproni? Tek Allahu është shumë e urryer të thoni atë që nuk e punoni.” Saff 2-3

Gjithashtu Allahu i Lartësuar thotë:

“A po i urdhëroni (thirrni) njerëzit për punë të mira e veten tuaj po e harroni? Ndërsa ju e lexoni librin. A nuk po mendoni?” Bekare 44

Çdo thirrës musliman duhet të ketë parasysh se mosvënia në praktikë e diturisë dhe mosveprimi

i atyre obligimeve që ua mëson të tjerëve të shpie drejt zjarrit të xhehenemit, një përfundim shumë i tmerrshëm. Një thirrës i tillë do të pyetet nga banorët e xhehenemit: “A nuk ishte ti që na urdhërova në të mirë?” siç është treguar qartë në këtë thënie të të Dërguarit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem:

“E ata, banorët e zjarrit, do t'i thonë: “O filan, a nuk ishte ti që na urdhërova në të mirë dhe na ndalove nga e keqja?” E ai thotë: “(Po) Unë isha që urdhërova të tjerët në të mirë ndërsa vetë nuk e kam punuar dhe i kam ndaluar nga e keqja, ndërsa vetë e kam punuar.” Buhariu

Ky do të jetë përfundimi i atij që nuk vepron me diturinë që ka mësuar.

4) Urtësia

Urtësia luan një rol shumë të rëndësishëm te thirrësi musliman. Në shumë raste urtësia është shkak kryesor që njerëzit ta pranojnë këtë thirrje të bekuar dhe të bëhen pjesëtarë të saj. Allahu i Mëshirshëm na ka treguar në librin e Tij, Kur'anin, që thirrjen në rrugën e Tij ta bëjmë me urtësi dhe këshilla të mira.

Allahu Fuqiptotë thotë:

“Ti (Muhamed) thirr për në rrugën e Zotit tënd me urtësi e këshillë

të mirë dhe polemizo me ata (kundërshtarët) me atë mënyrë që është më e mira. Zoti yt i di më së miri ata që janë larguar nga rruga e Tij dhe (Ai) i di më së miri ata që janë në rrugën e drejtë (rrugën e Allahut).” Nahel 125

Urtësia është një nga dhuntitë e shumta të Allahut Fuqiptotë që ia dhuron atij që do, e kujt i është dhënë urtësia i është dhënë e tërë e mira, mirëpo këtë e dinë vetëm të zotët e mendjes, siç ka thënë Allahu i Lartësuar në Kur'an:

“Ai ia dhuron urtësinë kujt të dojë, e kujt i është dhënë urtësia, atij i është dhuruar mirësi e madhe, mirëpo këtë nuk e kupton kush përveç të mençurve.” Bekare 169

*“E kush është në rrugë më të mirë se ai që thërret në rrugën e Allahut, që bën vepra të mira dhe thotë: “Unë jam prej muslimanëve?”
Fus-silet ajeti 33*

Shumë njerëz në kohën e të Dërguarit tonë sal-IAllahu alejhi ve sel-lem e pranuan Islamin për shkak të urtësisë që kishte i Dërguari i Allahut sal-IAllahu alejhi ve sel-lem ndaj tyre. Prej tyre ishin Thumamete ibën Ethali, Allahu qoftë i kënaqur me të, i cili ishte prijësi i Jemames, Zejd ibën Saneh, Allahu qoftë i kënaqur me të, i cili ishte një nga udhëheqësit fetar të çifutëve e shumë të tjerë.

5) Të ketë parasysh kategoritë e atyre që fton në Islam

Thirrësi musliman duhet të ketë parasysh kategoritë e atyre që fton në këtë fe të pastër, pasi kjo ndikon pozitivisht tek i ftuari. Thirrësi islam duhet të fillojë nga ajo që është më e rëndësishme për atë që ftohet e kështu me radhë deri në fund. Pra, ka dallim thirrja e ateistit në Islam nga ajo e të krishterit. Gjithashtu thirrësi musliman duhet të ketë parasysh këtë çështje edhe tek ata që kanë besuar, mirëpo nga përtacia ose pakujdesia e tyre kanë lënë anash disa nga obligimet që duhen bërë.

Nëse shfletojmë historinë e të Dërguarit të Allahut sal-IAllahu alejhi ve sel-lem, do të hasim në shumë raste se si i Dërguari i Allahut sal-IAllahu alejhi ve sel-lem e ka pasur parasysh këtë çështje. Pra, çdo thirrës musliman duhet të ketë shembull të vetin të Dërguarin e Allahut sal-IAllahu alejhi ve sel-lem dhe të marrë mësim nga metodat e tij të thirrjes me kategoritë e të ftuarve në këtë fe. Allahu i Madhëruar thotë: **“Ju e kishit shembullin më të mirë në të Dërguarin e Allahut.”** Ahzab 21

6) Durimi

Që thirrësi musliman të jetë i suksesshëm në thirrjen e tij, ai patjetër duhet të bëjë durim ndaj të thirrurit. Thirrësi musliman gjatë këtij misioni mund të sprovohet me sprovat e shumta, mirëpo këto nuk duhet ta bëjnë të

jetë i luhatshtëm dhe ta lërë anash këtë punë. Duhet të bëjë durim ashtu si duruan ata që ishin para tij, duke filluar prej të Dërguarve të Allahut sal-IAllahu alejhi ve sel-lem e deri tek thirrësi më i rëndomtë.

Duhet të mendojë gjithmonë se shpërblimi i durimtarit është shumë i madh. Allahu i Mëshirshëm thotë:

“... ndërsa durimtarëve u jepet shpërblimi i tyre pa masë.” Zumer 10

I Dërguari ynë sal-IAllahu alejhi ve sel-lem, edhe pse është njeriu më i dashur tek Allahu i Lartësuar, u sprovua me sprovat e shumta gjatë misionit të tij, mirëpo asnjëherë nuk u hamend dhe u lëkund në qëllimin dhe detyrën që kishte. Kur shkoi për të thirrur popullin e Taifit në Islam, ata urdhëruan fëmijët dhe robërit e tyre që ta fyenin e t'i gjuanin me gurë, derisa e përgjakën, por ai sal-IAllahu alejhi ve sel-lem prapë bëri durim dhe u lut për ta që t'i udhëzojë Allahu në rrugë të drejtë sepse ishin popull që nuk e njihnin të vërtetën.

Ky është një shembull me rëndësi të veçantë për të gjithë thirrësit muslimanë, nëse dëshirojnë të jenë të suksesshëm në thirrjen e tyre.

Në fund, e lus Allahun e Lartësuar me Emrat e Tij të bukur dhe me Cilësitë e Tij të larta, që të na forcojë në këtë fe dhe të na shpërblejë të gjithëve me xhenetin Firdevs!

Sabahudin Selimi

“O ju të cilët keni besuar, përse e thoni atë që nuk e veproni? Tek Allahu është shumë e urryer të thoni atë që nuk e punoni.” Saff 2-3

SISTEMI FAMILJAR NË ISLAM (2)

Përgjegjësia e gruas në familje

Përderisa është burri ai i cili është ngarkuar me menaxhimin e jashtëm ekonomik të familjes, siç e sqaruar më sipër, në anën tjetër është gruaja ajo e cila është përgjegjëse për menaxhimin e brendshëm të familjes; ruan shtëpinë e burrit të saj në mungesë dhe në prezencë të tij, ruan pasurinë e tij, fëmijët e tij. Po kështu ajo kryen edhe punët e tjera të shtëpisë.

Për gjithë këtë, gruaja gëzon respekt dhe vend të lartë të gjithë pjesëtarët e familjes, përderisa ajo e ka ruajtur përgjegjësinë e saj të brendshme dhe nuk e ka kaluar këtë cak për të bërë ato punë që i përkasin burrit dhe që janë të rënda dhe jashtë natyrës së saj.

Islami nuk i ka bërë padrejtësi gruas

Dëgjojmë zëra të shumtë e të urryer të cilët thonë se Islami i ka rrënuar të drejtat e gruas, i ka bërë

padrejtësi asaj, nuk i ka dhënë liri të plotë, nuk e ka barazuar atë me burrin si dhe shumë shprehje të tilla të përkthyer nga ato që shkruajnë armiqtë e Islamit kundër Islamit.

Në realitet, thënësit e këtyre hipotezave janë prej atyre që i përkasin njërit prej dy llojeve: Njëri prej tyre është një injorant i madh, i cili ka dëgjuar njerëzit duke e thënë këtë shprehje dhe e ka pasuar atë, saqë është bërë edhe mik i tyre, madje edhe tellall i tyre, që përcjell idetë e tyre dhe sigurisht nuk ka dije ku të bazohet për atë që thotë, por vetëm bërtet e bën tellallin, flet atë që nuk e di.

Nga ky njeri janë mashtruar shumë njerëz të cilët nuk kanë njohuri islame aspak, e sidomos disa gra të cilat kanë marrë kulturë joislame apo disa injorante të cilat pasojnë verbërisht pa udhëzime.

Ky lloj njerëzish humbin, por humbin edhe të tjerët, se në vetvete janë injorantë, por në të njëjtën kohë injorojnë se janë injorantë, ashtu siç thotë edhe poeti:





Nëse ti injoron se je injorant, atëherë kjo është injorancë mbi injorancë! Ndërsa i dyti është një intrigant i cili mundohet të përgatisë kurthe për Islamin dhe muslimanët, i cili dëshiron t'ua prishë atyre fenë dhe moralin e tyre, duke filluar nga rrënimi i familjes, i ndikuar nga armiqtë e Islamit dhe zbatues i planeve të tyre për luftimin e Islamit.

Si ky edhe ai i pari janë ata të cilët e ngrenë këtë zë të urryer në çdo vend duke u munduar të mashatrojnë dhe prej atyre janë ndikuar shumë muslimanë injorantë duke menduar se kjo thirrje është në dobi të tyre, kështu që zërave të tyre iu bashkuan edhe zëra të tjerë. E me këtë gjë gruaja muslimane, e ndikuar nga ato thirrje, bëhet e padrejtë ndaj fesë së saj duke e akuzuar atë se i ka bërë padrejtësi asaj. Dhe kush? Ai Islam i cili e ngriti atë në vendin më të lartë. Veç sikur ta dinte e ta perceptonte këtë! Por ku është perceptimi të gratë tona, me përjashtim të atyre që dëshiron Allahu! Tek Allahu ankohemi e Atij i kërkojmë ndihmë!

Prandaj çdo grua muslimane e kulturuar duhet që ta mësojë fenë e saj dhe të njohë vendin dhe nderin që Islami i ka dhënë asaj, jo të pasojë çdo lloj tellalli mendjelehtë.

E në të njëjtën kohë duhet që ajo të shikojë edhe ligjet e të huajve, si ato franceze dhe të tjera, që të mësojë qëndrimet e atyre ligjeve ndaj gruas. Pastaj të mësojë se si ka qenë pozita e gruas para Islamit, kur ajo konsiderohej prej gjërave të ulëta, të pavlera dhe pa asnjë lloj respekti e vendi. Dhe ka për të

gjetur se atë nuk e ka ngritur dhe nderuar veçse Islami.

Gruaja gëzon të njëjtat të drejta civile si edhe burri

Gruaja muslimane gëzon liri të plotë në të drejtat civile dhe shoqërore. Në këto të drejta, ajo është njësoj si edhe burri.

Gruaja muslimane ka drejtë të blejë, të shesë, të dhurojë dhe të pranojë dhurata, të marrë apo të japë borxh dhe të veprojë si të dojë me pasurinë e saj. Ajo gëzon të gjitha të drejtat ekonomike që gëzon edhe burri.

Të drejtat fetare të gruas muslimane

Gruas muslimane i janë bërë legjitime të gjitha adhurimet sikurse edhe burrit. Ajo falet, agjëron, jep zekat nga pasuria e saj, shkon në haxh dhe shpërblehet për adhurimet dhe bindjet e saj ndaj Allahut, ashtu siç shpërblehet edhe burri, pa pasur dallim shpërblimi i saj nga ai i burrit. Islami madje ia ka lehtësuar gruas disa adhurime duke marrë parasysh gjendjet e saj të ndryshueshme, siç i lejon asaj p.sh.: mosfaljen e namazit kur është me të përmuajshmet dhe as nuk e obligon kompensimin e tij pasi ajo të pastrohet, ngase kjo gjë ka vështirësi dhe mundime.

Allahu i Madhëruar thotë: "...dhe nuk ka vënë mbi ju ndonjë mundim në fe." Haxh:

Gjithashtu ajo lirohet nga agjërimi në ato ditë që gjendet me të përmuajshmet, porse i plotëson ato sepse në to nuk gjen vështirësi, ndryshe nga namazi. Po kështu edhe për gratë lehonë janë të njëjtat rregulla.

Liria e gruas muslimane në martesë

Islami i ka dhënë gruas liri të plotë në martesë. Është ajo e cila e zgjedh vetë martesën me një burrë të mirë para se ta obligojë atë përgjegjësi i saj në atë që ai zgjedh. Madje atij nuk i lejohet ta martojë atë vetëm se me lejen e saj të qartë duke u shprehur, nëse është e vejë, pasi ajo i ka provuar burrat dhe nuk ka turp të thotë po apo jo. Ndërsa për beqaren e virgjër mjafton si leje prej saj heshtja e saj kur të pyetet, porse pa tjetër duhet të pyetet. Edhe nëse babai i saj e marton atë kur ajo është e vogël, d.m.th. para rritjes (kohës së pjekjes seksuale), ajo ka të drejtën e zgjedhjes kur të rritet; ta pranojë apo ta refuzojë atë martesë.

Ky është ligji i Islamit në martesë, saqë i Dërguari i Allahut, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, thotë: "Nuk martohet e veja derisa të merret urdhër nga ajo dhe nuk martohet e virgjëra derisa të kërkohet leje nga ajo. Dhe leja e saj është heshtja e saj."^[1] E transmeton Buhariu nga hadithi i Ebu Hurejrës.

Trashëgimia e gruas në Islam

Thirrësit e barazisë ndërmjet burrit dhe gruas janë përqendruar shumë në këtë pikë dhe kanë arritur që me anë të saj t'i humbin shumë nga muslimanet e pavëmendshme, duke ua zbukuruar atyre se Islami i privilegjon burrat mbi gratë duke u dhënë nga trashëgimia më shumë sesa grave, duke i dhënë një burri sa dy grave!

[1] Transmeton Buhariu (5136) dhe Muslimi (1419), nga hadithi i Ebu Hurejrës.

Në përgjigje të kësaj hipoteze ka disa variante.

Është e vërtetë se Islami i jep burrit sa hisja e dy grave, por ky dallim në trashëgimi nuk tregon se burri ka privilegj mbi gruan në çdo gjë tjetër, siç do ta shohim në vazhdim me lejen e Allahut.

Pikë së pari, këtu nuk ka ndonjë ulje të gruas, porse kjo është një ndarje e drejtë.

Qartësimi i kësaj është në atë që kemi përmendur më herët, se Islami e obligon burrin për furnizimin e familjes, e cila përbëhet nga grua dhe fëmijët, madje edhe nga të gjithë ata nevojtarë prej të afërmeve të tij, ndërsa gruan nuk e ka obliguar që të shpenzojë as për veten e saj dhe as shpenzimet për burrin e vet, edhe nëse ajo është më e pasur se burri i saj. Ndërsa para martesës, grua i ka shpenzimet nga familja e saj.

Atëherë, a është e drejtë që gruas për të cilën shpenzon burri t'i jepet njësoj (në trashëgimi) sikur atij i cili shpenzon për të?!

Besoje se grua muslimane e drejtë do të shpenzojë të japë përgjigjen e kësaj pyetjeje para burrave duke thënë: Kjo nuk do të ishte kurrë e drejtë!

Por e drejta është ajo që ka vendosur Islami, i cili i ka dhënë secilit të drejtën e vet dhe lavdëruar qoftë vetëm Allahu!

Udhëtimi i gruas në Islam

Pika e dytë në të cilën mbështeten thirrësit për lirinë e gruas dhe barazinë e saj me burrin, është problemi i udhëtimit të gruas. Ata thonë: Islami nuk i lejon asaj të udhëtojë ashtu siç ia lejon burrit, madje as udhëtimin për kryerjen e obligimit të haxhit. Përse kështu?!

Çudia me këta lloj njerëzish është se shumë herë ata e përmbysin realitetin e gjërave me qëllim që të nxjerrin njerëzit gabimtarë, duke



konsideruar përçmimin nder dhe nderin përçmim, ashtu si kanë bërë edhe në këtë pikë.

Dhe për të ardhur keq, gruaja muslimane injorante dëgjon lloj-lloj tellalli për shkak të injorancës së saj në çështjet e fesë së saj, duke iu përgjigjur edhe ndjenjave të veta disa herë.

Në të vërtetë, Islami nuk e ka ndaluar gruan nga të udhëtuarit në vende të lejuara, por e ka kushtëzuar udhëtimin e saj me një kusht të vetëm. Ky kusht në realitetin e tij është nderim për të dhe mbrojtje e nderit të saj, po sikur ta dinin!

Islami ka vënë kusht që gjatë udhëtimit gruaja të jetë e shoqëruar nga një i afërm i saj, nga ata me të cilët asaj i ndalohet martesja përjetësisht, si babai apo vëllai i saj, pasi këta janë të gatshëm të flijojnë veten për mbrojtjen e saj, për të ruajtur nderin e saj, që asaj mos t'i afrohen ujqit veçse mbi kufomat e tyre.

e

Gjithashtu ata janë në shërbimin e saj gjatë udhëtimit në momentet kur ajo ka nevojë për shërbim.

A thua kushtëzimi i Islamit për gruan gjatë udhëtimit me këtë kusht llogaritet si nënçmim për gruan apo nderim për të?! Vërtet që kjo është një prej katastrofave të mëdha!

Kështu që gruaja muslimane duhet ta perceptojë mirë përgjigjen për këtë dilemë!

Ndërsa udhëtimin në esencën e tij Islami nuk e ndalon.

Gruaja mund të udhëtojë për në haxh, për tregti, për të vizituar familjen dhe farefisin e saj, për kërkimin e dijes e për qëllime të tjera, përderisa është i pranishëm kushti, që është prania e burrit apo e dikujt që është nga gjaku i saj dhe që i ndalohet martesja me të.

Ky është vendimi islam për udhëtimin e gruas, o ju muslimanë, siç thotë i Dërguari

i Allahut, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem: "Nuk i lejohet asaj gruaje e cila beson në Allahun dhe Ditën e Gjykimit që të udhëtojë sa distanca e një dite (ecje), vetëm nëse ka me vete një burrë mahrem (burrin e vet ose një të afërm me të cilin i ndalohet martesë)." [2]

Ky hadith është përcjellë me shprehje dhe rrugë transmetimi të ndryshme, por të gjitha argumentojnë se Islami e kushtëzon udhëtimin e gruas me praninë e burrit të saj ose të një personi me të cilin asaj i ndalohet martesë përgjithmonë.

E kjo konsiderohet respekt dhe nder për gruan muslimane, sikur ajo ta dinte, dhe Allahu është Ai i Cili jep sukses.

Qëndrimi Islamit në lidhje me zbulimin e gruas, përzjerjen dhe të veçuarit e saj me një mashkull të huaj

Qëndrimi i Islamit kundrejt kësaj injorance është i qartë. Ai është qëndrim i natyrshëm dhe i logjikshëm, madje i pranuar edhe nga shijet e natyrshme. Islami i kundërshton rreptësisht këto injoranca e posaçërisht injorancën e të vetmuarit, për të cilën i Dërguari i Allahut, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "Nuk vetmohet një burrë me një grua vetëm se shejtani është i treti i tyre." [3]

"Të mos vetmohet askush me një grua, vetëm se të shoqëruar me një mahrem." [4]

Kështu thoshte i Dërguari i Islamit, o ju muslimanë!

Ndërsa për ndalesën nga të zbuluarit (në sy të të huajve), Allahu i Madhëruar thotë: "Dhe qëndroni në shtëpitë tuaja dhe mos e shfaqni veten siç bënin në kohën e xhahilisë (periudha e injorancës para Islamit)." Ahzab:

33

Dhe thotë duke iu drejtuar të Dërguarit dhe të dashurit të Tij, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem: "O Pejgamber! Thuaju bashkëshorteve të tua dhe bijave të tua edhe bashkëshorteve të besimtarëve të lëshojnë vellon (mbulesën) e tyre mbi gjithë trupin e tyre. Kjo do të ishte më e mirë që ato të mund të dallohen (si gratë ndershme) që të mos i shqetësojë (e ngacmojë) askush. Dhe Allahu është gjithnjë Falës i Madh, gjithnjë Mëshirëplotë." Ahzab: 59

Kështu e urdhëron Islami gruan muslimane duke filluar nga nënat e pastra të besimtarëve e deri në ditët tona dhe do të vazhdojë deri kur Allahu ta shkatërrojë Tokën dhe çfarë ka në të.

Ai e urdhëron atë për dëlirësi, druajtje (të jetë e turpshme) dhe mospërzjerje, pasi turpi (droja) është prej degëve të imanit. Dhe e ndalon atë nga këto gjëra të ulëta me një ndalim të rreptë, pasi ato janë rrugët e fesadit, e prishjes së moralit. Nëse preken shoqëritë nga këto, atëherë humbin dhe shkojnë. Një poet ka thënë të vërtetën në fjalën e tij:

"Popujt qëndrojnë aq sa qëndron morali i tyre, e nëse ai shkon, kjo është edhe shkuarja e tyre!"

*Autor: Muhamed el-Xhami
Përshtati: Unejs Murati*

[2] Transmeton Buhariu (1088) dhe Muslimi (1339), nga hadithi i Ebu Hurejrës.

[3] Transmeton Tirmidhiu (2165), nga hadithi i Umerit. Shejh Albani, Allahu e mëshiroftë, e ka konsideruar të saktë në "Sahih el Xhami" (2546).

[4] Transmeton Buhariu (5233) dhe Muslimi (1341), nga hadithi i Ibën Abbasit.

MËNYRA E TRAJTIMIT TË RISIVE NË FE - BIDATET

Robër të Allahut! E dimë të gjithë se mëkatet tona janë gjëra të rrezikshme për personin dhe popullin në përgjithësi. Mëkatet janë shkaktare të shkatërrimit dhe kataklizmës, shkaktare të nënçmimit dhe varfërisë, shkaktare për përhapjen e sëmundjeve të shumta të urryera, të humbjes së luftës ndaj armikut dhe jemi të dobët o vëllezër vetëm pasi kemi bërë mëkat ndaj Krijuesit. Mëkatet janë shkaktare të çdo të keqeje, shkaktare të humbjes së dynjasë dhe të ahiretit.

Robër të Allahut!

Cili është shkaku që i nxori prindërit tanë nga xheneti, vendbanim i mirësive në dynja, vendbanim i të këqijave dhe vuajtjeve? Pa dyshim se mëkatet.

Cili ishte shkaku që u fundos populli i Nuhut në përgjithësi?

Cili ishte shkaku që u fundos Faraoni dhe populli i tij?

Cili ishte shkaku që u shkatërrua populli i Adit?

Cili ishte shkaku që u përmbys Karuni me pasurinë e tij? S'ka dyshim se mëkatet.

Allahu në Kur'an thotë: **“...secilin prej tyre e**

kemi dënuar për shkak të mëkatit të vet.” Ankebut: 40

“...e për shkak të mëkateve të tyre i shkatërruam dhe pas tyre sollëm breza të tjerë.” En'am: 6

Robër të Allahut!

Pasi na u qartësua se mëkatet janë shkak i të gjitha të këqijave për umetin, si për persona të caktuar ashtu edhe për popullin në përgjithësi, dijeni vëllezër të dashur se bidati (risia) është edhe më e keqe dhe më shkatërrimtare se mëkatet si për personin ashtu edhe për popullin në përgjithësi.

Shejhul-islam Ibën Tejmije, Allahu e mëshiroftë, thotë: “... Bidati është më i keq se mëkati, siç thotë edhe Sufjan eth-Thevri: “Bidati është më i dashur për Iblisin sesa mëkati, se mëkatarin pendohet nga mëkati i tij, ndërsa bidatçiu nuk pendohet nga bidati i tij...” Mexhmuatul fetava 11/472

Shejtani kujdeset që ta transferojë njeriun nga besimi në mosbesim, nga njëshmëria në politeizëm. E, nëse nuk mundet, kalon në fazën e dytë, mundohet ta transferojë njeriun nga suneti në bidat. E, nëse nuk mundet, kalon në fazën e tretë, duke u munduar ta transferojë

njeriun nga respekti në mëkat.

Lumturia në dynja (në këtë botë) dhe në ahiret arrihet me tevhid (njëshmëri), sunnet, respektim dhe vepra të mira.

Pikëllimi në dynja (në këtë botë) dhe në ahiret është me politeizëm, bidate dhe mëkate (vepra të këqija).

Bidati është më i dashur për Iblisin sesa mëkati. Këtë e ka argumentuar shejhul-islam Ibën Tejmije me dy hadithe të Muhamedit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem.

1- Argumentohet me hadithin e një njeriu të quajtur Himar. “Me të vërtetë një njeri e kanë quajtur Himar. Ai ka pirë alkool, mirëpo përsëri e ka bërë për të qeshur Muhamedin, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të. Çdoherë kur e kanë sjellë te Muhamedi, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, ai e ka ndëshkuar sipas asaj që ka merituar. Nga ardhja e tij e shpeshtë te Muhamedi, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, një njeri e mallkoi duke thënë sa shumë që po sillë (për t’u ndëshkuar) tek i Dërguari i Allahut! Muhamedi, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, tha: “Mos e mallko atë, se ai e do Allahun dhe të Dërguarin e tij.” Transmeton Buhariu

Edhe pse ai ka përdorur alkoolin dhe ka bërë mëkat ndaj Allahut, Muhamedi, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, i ndaloi sahabët që ta mallkojnë atë dhe dëshmoi për besimin e tij të mirë duke thënë “me të vërtetë ai e do Allahun dhe të Dërguarin e Tij”.

2- Dhe hadithi i dytë është ai i njeriut që kundërshtoi ndarjen e plaçkës së luftës (nga Muhamedi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem). “Muhamedi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ishte duke ndarë plaçkën e luftës kur erdhi një njeri me mjekër të gjatë e kokë të rruar. Mes syve të tij janë parë shenjat e

sexhdes, mirëpo e ka kundërshtuar ndarjen e Muhamedit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem. Për këtë ka thënë Muhamedi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem: “Do të dalin (do të lindin) nga pasuesit e tij, nga origjina e tij, një popull, njerëz që do t’ua kalojnë me namaz, me agjërim, me të lexuar të Kur’anit, por leximi i tyre nuk arrin as deri te fyti i tyre dhe do të dalin nga Islami ashtu siç del shtiza nga harku i saj. Nëse i takoj, do t’i luftoj si Adin.” Transmeton Buhariu

Shikoni, vëllezër të dashur, falen, agjërojnë, lexojnë Kur’an dhe nuk u shtohet vetëm se largimi nga Allahu për arsye të bidatit të tyre.

Robër të Allahut!

Kur u qartësua për ne se bidatçiu është më i rrezikshëm se mëkatari, se bidati është më i rrezikshëm se mëkati, erdhi kujdesi dhe këshilla që të ruhemi nga shoqërimi me bidatçinjtë dhe ulja me ta, nga të dëgjuarit dhe shikimi i tyre.

1- Sejjid bin Xhubejri, Allahu e mëshiroftë, thotë: “Sikur të shoqërojë biri im një fasik hajdut sunni është më e dashur për mua sesa të shoqërojë një të devotshëm bidatçi.” El ibanetu Sugra: 132

Popull musliman, ç’është me ju që po parashikoni se fitorja është në duar të bidatçinjve?! Po shpresoni se fitorja vjen nga bidatçitë, rafiditë, të cilët nuk i duan pasuesit e Sunnetit dhe shpresojnë për ta shkatërrim?!

2- Ibën Abasi, Allahu qoftë i kënaqur me të, thotë: “Mos u ul me pasuesit e epsheve- dhe ata janë bidatçinjtë- sepse ulja me ta është sëmundje e zemrave.” El-Axhurij: f. 61

3- Fudajl Ibën Ijadi ka thënë: “Nëse e shikon një bidatçi në rrugë, atëherë merr drejtim të kundërt.” Gjithashtu thotë: “Kush e ndihmon një pasues të bidatit, vetëm se ka ndihmuar në shkatërrimin e Islamit.”

Dhe ajo që paraqesin bidatçinjtë përmes kanaleve të ndryshme e shkatërron Islamin, edhe pse paramendojnë se kanë bërë diçka. Largohuni prej tyre, o robër të Allahut!

Ai, Allahu e mëshiroftë, thotë: “Kush e marton fisniken e tij, domethënë vajzën e tij, me bidatçiun, vetëm se e ka ndërprerë fisin (marrëdhëniet farefisnore apo është ndarë prej tyre në mënyrë islame).” Ibën Xhevziyye, Telbis iblis: 14 Ebu Idris Eshavlani thotë: “Sikur të shoh një zjarr të ndezur në xhami dhe të mos kem mundësi ta fik atë është më e dashur për mua sesa të shoh një bidat dhe të mos mund ta ndryshoj.”

El I’atizam: 1/82

Ndërsa Abdullah Ibën Mubareku thotë: “Ndalohet për ju ulja me pasuesit e bidateve.” El-Lalekai: 1/137

Robër të Allahut!

Bidati është rrezik i madh, është më i keq sesa mëkati për personin dhe për popullin. Për këtë erdhi Islami, duke e ndaluar shpikjen në fe dhe duke na këshilluar që të ruhem nga bidatçinjtë, nga ata të cilët shpikën në fenë e Allahut.”

I. Nga libri i Allahut

Allahu i Lartësuar thotë: “Dhe se kjo është rruga (feja ime e drejtë që e caktova për ju), përmbajuni kësaj, mos ndiqni rrugë të tjera e t’ju ndajnë nga rruga e Tij. Këto janë porositë e Tij për ju, ashtu që të ruheni.” En’am: 153

Dhe rruga e drejtë për të cilën na urdhëroi Allahu është feja (rruga) të cilën e ka zgjedhur (e kanë kaluar) Pejgamberi, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi ta, dhe sahabët e tij.

Dhe rrugicat të cilat Allahu na ndaloi që t’i zgjedhim dhe të kalojmë mbi to janë rrugicat e pasuesve të bidatit dhe të epsheve, në krye të të cilave është një shejtan që fton në të. Allahu në Kur’an thotë: “... në ditën kur ka fytyra që zbardhen dhe fytyra që nxihen.” Alu Imran: 106

Ibën Abasi, Allahu qoftë i kënaqur me të, ka thotë: “Ata që i kanë fytyrat e tyre të ndritshme janë pasuesit e Sunnetit dhe të Xhematit dhe zotëruesit e diturisë, ndërsa ata të cilëve u nxihen fytyrat e tyre janë pasuesit e bidatit dhe humnerës.”

II- Nga Sunneti i Muhamedit sal-IAllahu alejhi

ve sel-lem kanë ardhur hadithe për urrejtjen e bidatit në fe

1- Muhamedi sal-IAllahu alejhi ve sel-lem thotë: “Kush shpik diçka në fenë tonë, e që nuk është në të, ajo është e refuzuar.” Mutefekun alejhi

“Kush vepron diçka që nuk është në pajtim me çështjen tonë, ajo vepër është e refuzuar.” Transmeton Muslimi

2- Muhamedit sal-IAllahu alejhi ve sel-lem, kur ka ligjëruar në hytbe të xhumasë, i janë skuqur sytë, ka folur me zë të lartë dhe i është shtuar hidhërimi sikur të ishte këshilltar ushtarak. Ai ka thënë: “Me të vërtetë fjala më e mirë është ligji i Allahut dhe udhëzimi më i mirë është udhëzimi i Pejgamberit sal-IAllahu alejhi ve sel-lem dhe gjërat e këqija janë risitë e çdo risi është e humbur.” Dhe në shtojcë të Nesaiut: “Dhe çdo e humbur është në zjarr.” Sahihut tergibi vet-terhib: 1/128

3- Në këshillën e mrekullueshme me të cilën i këshilloi shokët e vet pas namazit të sabahut, sahabët i thanë: “Si të ishte kjo këshilla e fundit, prandaj na porosit me diçka.” Dhe pasi i këshilloi për devotshmëri ndaj Allahut dhe dëgjim e respektim, u tha: “Ruajuni nga gjërat e shpikura dhe çdo e shpikur është risi (bidat) dhe çdo bidat është në humbje.” Transmeton Muslimi

4- Muhamedi sal-IAllahu alejhi ve sel-lem thotë: “Kush largohet nga sunneti im, nuk është nga ne.” Sahihut-tergibi vet-terhib: 58

5- Muhamedi sal-IAllahu alejhi ve sel-lem thotë: “Kush thërret në udhëzim, ka shpërblim sikur shpërblimin e atyre që e pasojnë ata, duke mos u pakësuar shpërblimi i atyre. Kush thërret në dalalet (humbje, devijim), ka mëkat sikur mëkati i atyre që e pasojnë duke mos iu pakësuar mëkati i tyre.” Transmeton Muslimi

III- Gjurmët e sahabëve, të imamëve të drejtë dhe të atyre që vijnë pas tyre na kanë këshilluar që të ruhem nga bidati dhe pasuesit e tij

1- Ebu Bekri, Allahu qoftë i kënaqur me të, thotë në hytben e tij: “Me të vërtetë unë jam pasues dhe nuk jam shpikës. Nëse qëndroj në këtë, më pasoni. E, nëse devijoj, më forconi.”

2- Omeri, Allahu qoftë i kënaqur me të, thotë: “Largohuni (ruajuni) nga pasuesit e logjikës sepse ata janë armiq të Sunnetit. U janë paraqitur ha-

dithet dhe kanë thënë logjika (i kanë dhënë përparësi logjikës). Humbën dhe i humbën edhe të tjerët.” Transmeton El-Lalekai: 1/123

3- Ibën Mes’udi, Allahu qoftë i kënaqur me të, ka thënë: “Ju është ndaluar juve shpika në fe, ekstremizmi në të dhe të thelluarit e tepërt në të, prandaj përmbajuni të hershmes (fesë që i është shpallur Pejgamberit tonë dhe shokëve të tij).” Ed-Darimi: 1/54

4- Ibën Abasi, Allahu qoftë i kënaqur me të, thotë: “Kapuni dhe përqendrohuni te gjurmët dhe mos shpikni.” Ibën Vedah: 1/54

5- Ibën Omeri, Allahu qoftë i kënaqur me të, thotë: “Çdo risi është në humbje, edhe pse njerëzit e shohin të mirë.” Transmeton El-Lalekai në Sherhu Sunneh: 126

Ibën Omeri ka dëgjuar një njeri që ka teshtirë dhe ka thënë se falënderimi i takon Allahut dhe përshëndetjet qofshin mbi Muhamedin sal-IAllahu alejhi ve sel-lem, prandaj i ka thënë atij se “i Dërguari sal-IAllahu alejhi ve sel-lem nuk më ka mësuar kështu, por ka thënë: “Nëse teshtin dikush nga ju, le ta falënderojë Allahun”. Dhe nuk ka thënë që të dërgojë përshëndetje mbi Pejgamberin sal-IAllahu alejhi ve sel-lem.” Hasen Tirmidhi, 2838

Shikoni, o robër të Allahut, se si ia ka ndaluar këtij njeriu që të shtojë (salavatet, përshëndetjet për Pejgamberin sal-IAllahu alejhi ve sel-lem) për arsye se ka shtuar diçka nga udhëzimi i Muhamedit sal-IAllahu alejhi ve sel-lem.

6- Imam Maliku, Allahu qoftë i kënaqur me të, thotë: “Kush shpik në Islam një risi dhe e sheh atë të mirë, vetëm se ka predikuar se Muhamedi sal-IAllahu alejhi ve sel-lem e tradhtoi misionin e tij, pasi Allahu aze ve xhel thotë: “Sot plotësova për ju fenë tuaj.” Ajo që nuk ka qenë atë ditë fe, si ka mundësi të jetë sot fe?!”

Ka ardhur një njeri tek imam Maliku dhe e ka pyetur se ku ta veshë ihramin. I është përgjigjur: “Në Dhul-Hulefje, aty ku e ka veshur Pejgamberi, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të.” Pyetësi ka thënë: “Unë dua të vishem me ihram nga xhamia e Pejgamberit sal-IAllahu alejhi ve sel-lem, prej varrit të Pejgamberit sal-IAllahu alejhi ve sel-lem.” Imam Maliku i është përgjigjur: “Mos veopro ashtu. Frikësohem për ty nga fit-

neja.” Ka pyetur se cila është kjo fitne dhe i është përgjigjur: “Me të vërtetë po shton një sipërfaqe ecjeje me ihram”, i është përgjigjur imam Maliku. “E, çfarë fitneje më të madhe se të mendosh e ta shikosh veten se ia ke kaluar Pejgamberit sal-IAllahu alejhi ve sel-lem në të mira të cilat Pejgamberi sal-IAllahu alejhi ve sel-lem i ka pasur mangët. Me të vërtetë kam dëgjuar ajetet e Allahut aze ve xhel që thotë: “...le të ruhen ata që kundërshtojnë rrugën e tij (të të Dërguarit), se ata do t’i zërë ndonjë telash ose do t’i godasë dënim i hidhur.” Ebu Nuajm në Hilje: 6/326, Ibën Batta në Ibane: 97

7- Sejjid ibën Musejjebi, Allahu e mëshiroftë, i cili ka qenë prej tabiinëve, ka parë një njeri që pas lindjes së agimit ka falur më shumë se dy rekate, duke i zgjatur rukutë dhe sexhdet. Ai e ka ndaluar nga kjo për arsye se nëse lind agimi dhe njeriu fal dy rekate sunnet, nuk i lejohet atij të shtojë pas tyre derisa të falet farzi (i sabahut). Ky njeri është ngritur dhe ka falur nafle pas dy rekateve të mëngjesit, prandaj Sejjid Ibën Musejjebi e ka ndaluar nga ky veprim.

Ky njeri i ka thënë: “O Ebu Muhamed! A më dënon Allahu për namazin?” I është përgjigjur: “Jo, mirëpo të dënon që ke kundërshtuar Sunnetin.” Të tilla janë disa nga argumentet e bidatçinjve, të cilët të kundërvihen kur i këshillojnë të largohen nga bidati duke të thënë: “Namazi mos është haram?! Leximi i Kur’anit mos është haram?! Përmendja e Allahut mos është haram?!”...

Hytbe e ligjëruar nga hoxhë Ebu Islam Salih ibën Taha AbdulVahid, imam dhe hatib në një nga xhamitë e njohura të Jordanisë.

Përshtati: Unejs Shuajb Murati

NDARJA E FESË NË (LËVORE) DHE (BËRTHAMË) ËSHTË PREJ “RISIVE NË FE” TË SEKTEVE

Pyetja (4):^[1] Disa xhemate islamike e ndajnë fenë në lëvore (imtësira, gjëra të dorës së dytë, sekondare) dhe në bërthamë (prioritete), dhe thonë se ne duhet të mirremi me bërthamë, pa lëvore!

Cili është mendimi i juaj rreth kësaj ndarjeje?!

Dijetari i madh Albani [rahimehullah] përgjigjet: Ajo që shpirtit ia shton të keqen dhe mërzinë është se disa xhemate islamike të sotme, jo vetëm që nuk i japin rëndësi disa rregullave të rëndësishme të shariatit. Përkundrazi ata për disa dispozita të shariatit thonë: “Këto janë prej lëvoreve! Ne duhet të mirremi me bërthamë”!

Kjo në të vërtetë është një prej fatkeqësive më të mëdha që i ka goditur të rinjët e kohës prezente, sepse sikur kjo ndarje të kishte qenë legjitime, atëherë dijetarët do të kishin hulumtuar në shariat që t’i ndajnë ato, e pastaj edhe t’i kategorizojnë. Ashtu siç kanë vepruar dijetarët e Jurisprudencës islame në përgjithësi, kur

kanë veçuar farzin^[2] nga sunneti;^[3] kurse hanefitë në veçanti kanë bërë dallime mes farzit dhe vaxhibit.^[4]

Por, ky dallim në mes farzit dhe Sunnetit padyshim ka nevojë për ta njohur shariatin, Librin e tij, dhe sunnetin e peygamberit të tij sallAllahu alejhi ve sellem.

Ndërsa sa i përket lëvorës dhe bërthamës, kush duhet që të bëjë dallimin mes këtyre dyjave sikur të kishte qenë e vërtetë?!

Sigurisht se dijetarët duhet ta bëjnë këtë. Kurse kush është duke thënë: “Ne nuk duhet të punojmë me lëvore, por me bërthamë”?!

Ata janë Injorantët.

Mirëpo, pasojë e kësaj është shkatërrimi i islamit, ngase ai i cili për një çështje thotë: kjo është lëvore, ku e di ai, ndoshta ajo në të vërtetë është bërthamë?!

Kurse ai i cili e quan me të kundërtën: bërthamë; ku e di ai, ndoshta ajo është lëvore?!

Kjo ndarje ndodh shpesh, e posaçërisht në çështje të Besimit!

Saqë kur diskutohet për çështje të bes-

[1] Fetvaja nr.6973.

[2] Obligim fetar.

[3] Traditë e peygamberit tonë, mirëpo këtu ka kuptimin kur një vepër është e përlayer në fe të praktikohet e nuk është obligim, nëse e praktikon ka shpërblim te Allahu, e nëse e lë nuk ka ndëshkim, vetëm nëse e lë në tërësi, pra nuk e praktikon fare kurrë, atëherë qortohet.

[4] Edhe me termin “vaxhib” është për qëllim obligimi fetar, dhe ai në realitet është i njëjtë sikur farzi, dhe nuk ka dallim mes farzit dhe vaxhibit tek dijetarët islam përveç të dijetarët e drejtimit juridik Hanefij.

imit, ata shpërthejnë dhe thonë: “Na lëni rehat tani nga çështjet kundërthënëse”!

Por, në të vërtetë, cila çështje nuk është kundërthënëse?!

Atëherë pra, cila është dobia e kësaj ndarje?! Ngase, nëse ne bisedojmë për bërthamën, ata thonë: lëne këtë, kjo po i ndan radhët dhe xhematin! E nëse bisedojmë për atë që e quajnë lëvore! Ata thonë: “Na lëni rehat nga kjo lëvore, nuk duam të flasim për të në këtë kohë”!

Mirëpo, sikur këta njerëz të kishin menduar pak, do të kishin parë se Allahu krenar dhe fuqiplotë çdo gjë që e ka krijuar, e ka krijuar me urtësi, e po ashtu çdo gjë që e ka bërë të ligjshme, e ka bërë me urtësi.

Kështu që Allahukrenar dhe i madhërishëm kur krijoi pemët dhe farat, atyre u bëri lëvore dhe bërthamë...

Por, a ka mundësi që kjo krijesë e Allahut të jetë e kotë?!

Kurrresi!

Në të vërtetë sigurisht që lëvoren e ka krijuar për ndonjë arsye, e ajo është: që ta ruajë bërthamën nga prishja.

Kësisoj qëndron puna sikur Allahu i Lartësuar dhe Krenar të kishte bërë në sheriatin e Tij gjëra sekondare siç pretendojnë ata; sigurisht se legjitimiteti i asaj lëvore nuk do të kishte qenë i kotë, por në të do të kishte ndonjë urtësi të madhe...

Rreth këtij vendimi janë transmetuar hadithe të shumta nga Pejgamberi sallAllahu alejhi ve sellem që aludojnë në të, prej tyre: ajo që është transmetuar në hadithin kudsij:^[5] “...dhe do të vazhdojë robi të më afrohet me nafle, derisa ta dua atë, e kur ta dua atë, atëherë bëhem të dëgjuarit e tij që me të dëgjon, dhe të pamurit

[5] Fjalë e Allahut e transmetuar drejtpërdrejtë nga pejgamberi i Tij.



e tij që me të sheh, dhe dora e tij që me të godet, dhe këmba e tij që me të ec.^[6] Dhe nëse më kërkon diçka unë atij ia jap, e nëse kërkon mbrotje nga unë, unë e mbroj atë”.^[7]

Kurse në një hadith ka thënë: “Gjëja e parë që për të robi llogaritet në ditën e gjykimit është namazi, nëse atë e ka në rregull, atëherë tërë veprat e tjera i ka në rregull, e nëse jo, atëherë as veprat tjera nuk i ka në rregull”.^[8]

Ndërsa në një transmetim tjetër thotë: “Nëse i mungon diçka nga farzet e tija, Allahu thotë: “Shikoni se a ka robi Im ndonjë namaz vullnetar?! Që me të të plotësojë mangësitë e farzeve”.^[9]

Pra, muslimani është i varur prej nafileve, sepse nëse i lë nafilet, atëherë prishet bërthama dhe e humb atë.


E ne nëse përkujtojmë Fjalën e Allahut: **“Vërtetë që njeriu u krijua shumë i paduruar. I pakënaqur kur i bie e keqja. Dhe dorështrënguar kur i bie e mira. Përveç atyre që falin namaz”**;^[10] do të shohim se këta falës të namazeve siç është transmetuar në hadithe të sakta namazi i tyre nuk mund të shpëtojë prej ndonjë mangësie, ose në sasi ose në formë:

falësit ose i ikë ndonjë farz, nuk e fal në kohën e tij.

apo e fal në kohën e vet të duhur, por ka mangësi në formën e kryerjes së saj...

Dhe i tërë njerëzimi në përgjithësi nuk mund të shpëtojë nga këto dy mangësi; ndërsa sa i përket individëve në mes tyre: ata ndryshojnë, dikush e ka të mënçët këtë, e dikush atë.

Nëse kështu qëndron puna, atëherë këtu vie në konsideratë fjala e Pejgamberit sal-





lAllahu alejhi ve sellem: “Njeriu largohet nga namazi (pasi ta kryen), e atij i shkruhet një e dhjeta e saj, apo një e nënta e saj, apo një e teta e saj, apo një e shtata e saj, apo një e gjashta e saj, apo një e pesta e saj, apo një e katërta e saj, apo një e treta e saj, apo gjysma e saj” .^[11]

Ku shkoi gjysma tjetër?!

Pas tregtisë, pas bujqësisë...etj!

Padyshim që kësaj nuk mund t’i iket, sepse ai është njeri, kurse Zoti ynë i madhërishëm kur i përshkroi besimtarët, prej cilësive të tyre të para ka qenë Fjala e të **Lartësuarit: “Padyshim që besimtarët kanë shpëtuar. Ata të cilët në namazin e tyre janë të përkushtuar”**;^[12] cili prej neve gjykon mbi veten e tij se ai arrin tërë shpërblimin njëqindpërqind?!

Askush!

Apo cili prej neve mund të thotë për vetveten e tij sot: se ai gjithnjë është i përkushtuar?! Ndonjëherë... këtë e bën secili prej nesh inshaAllah; është i përkulur në ndonjë namaz, apo në ndonjë ditë... Mirëpo, të jetë cilësi e përhershme e tij; kjo siç thonë: është më e rrallë se qibruti i kuq! Pra, nëse kjo gjendje është e zakonshme tek njerëzit, dhe ka mangësi në namazin e tij, atëherë me çka zëvendësohet kjo mangësi..

Sigurisht se duhet të falim namaz vullnetar..

[6] “Afrimi tek Allahu duke u kujdesur në kryerjen e obligimeve dhe nafilet e shumta, është shkak që Allahu t’i përgjigjet lutjes së robit, ta ruajë atë dhe të përkujdeset për të. Dhe hadithi nuk është argument për zindikët e sufive të cilët pretendojnë me të se Allahu lirohet në trupa e bashkohet me ta (Panteizmi); siç edhe ka thënë el-Hafidh Ibën Rexheb el-Hanbelij në “Xhamiu el-Ulum vel-Hikem”: “Kush e komenton atë me diçka tjetër, ai veçse e ka komentuar me panteizëm, kurse Allahu dhe i Dërguari i Tij janë të pastër nga kjo”, “Behxhetun-Nadhirin” (1/179).

[7] Tra.Buhariu (6502) nga Ebu Hurejra.

[8] “Es-Silsile es-Sahihah” (1358).

[9] Sahihut-tergibi vet-terhib (540).

[10] Mearixh:19-22.

[11] “Sahih Ebi Davud” (761).

[12] Muëminun: 1-2.

Duke pasur parasysh, se edhe në këto namaze vullnetare do të ketë mangësi ashtu si në farze, mirëpo ato nafile që janë të plota u bashkëngjiten farzeve të mangëta... Këtu e keni rastin të shihni rëndësinë e fjalës së të Dërguarit sallAllahu alejhi ve sellem në hadithin kudsij: “Shikoni tek robi im a ka ndonjë nafile për të plotësuar mangësitë e farzeve”.

Pra, i tërë qëllimi nga kjo është se besimtari nuk duhet të jetë sikur arabiu i cili i patë thënë Pejgamberit sallAllahu alejhi ve sellem: “Vallahi nuk do të shtojë në këtë e as nuk do të pakësojë (nga farzet)”!

Kështu, ngase ai së pari ka qenë në natyrshmëri, kurse e dyta se Pejgamberi sallAllahu alejhi ve sellem kishte dëshmuar për të duke thënë: “Ka shpëtuar nëse e thotë të vërtetën”, ose “Do të hyjë në Xhennet nëse e thotë të vërtetën”.^[13]

Kurse sa na përket neve, ne sot nuk kemi këso dëshmie, që të thuhet edhe për neve ajo që u tha për atë arabium, apo ashtu siç i tha Pejgamberi sallAllahu alejhi ve sellem Umer ibën Hattabit kur ky i fundit i tha: më lejo o i Dërguar i Allahut t’ia hjeki qafën këtij munafiku (pra: Hatib Ibën Ebu Beltea), i tha: “Ai ka marrë pjesë në luftën e Bedrit; e ku e di ti?! Ndoshta Allahu ka shikuar se çfarë kanë Bedritë në zemrat e tyre e u ka thënë: “Veproni çfarë të doni, sepse juve ju kam falur”.^[14]

Prandaj, ne duhet të preokupohemi (sipas shprehjes së tyre, e që unë kërkoj mbrojtje tek Allahu nga shprehja e tyre) me lëvore; sepse lëvorja nuk është bërë pjesë e shëritit kot, por padyshim që është krijuar për ta ruajtur bërthamën..

“Padyshim që në të ka përkujtim, për atë

që ka zemër, ose që vë veshin e dëgjon duke qenë i vëmendshëm e dëshmues”.

Shkëputur nga libri “Pyetjet nga Shami që u përgjigjet Imam Albani”, të përmbledhura nga Alij Hasen el-Halebi.

Përshtati: Zejd Haziri

[13] Tra. Buhariu (6956) dhe Muslimi (11) nga Talha ibën Ubejdullah.

[14] Tra. Buhariu (3007) dhe Muslimi (2494) nga Alij ibën Ebu Talib.



ABDUL-AZIZ IBËN ABDULLAH

IBËN BAZI

Jeta dhe vepra e tij

Dijetari i nderuar Abdul-Aziz ibën Abdullah ibën Bazi, Allahu e mëshiroftë, u lind në kryeqytetin e Arabisë Saudite, Riad, më 12 Dhulhixhe të vitit 1330 hixhrij. Që fëmijë, dallohej nga të tjerët. E mësoi librin e Allahut (Kur'anin) përmendësh para se të hynte në moshën madhore dhe më pas vazhdoi kërkimin e diturisë nga dijetarët e atij vendi, si nga Muhamed ibën Abul-Latif, Salih ibën Abdul-Aziz, Muhamed Ibën Ibrahim Alu Shejh etj.

Në moshën 19-20 vjeçare humbi plotësisht shikimin nga një sëmundje e përhapur në atë kohë në vendin e tij, mirëpo kjo nuk ndikoi tek ai që të linte anash kërkimin e diturisë, madje e kërkoi diturinë me angazhim edhe më të madh se më parë.

Në fillim u punësua si gjykatës (kadi) në qytetin e quajtur Harexh. Më pas vuri re që angazhimi i tij në këtë detyrë e pengonte që të thellohej në kërkimin e diturisë, kështu që vendosi të largohej nga ky post.

Në vitin 1371 hixhrij, ai shkoi në Institutin e Riadit, që më vonë (më 1373 h.) do të shndërrohej në fakultet sheriati. Atje u emërua si ligjërues prej vitit 1373 hixhrij deri në vitin 1381, kur u transferua në qytetin e Medinës si prorektor i Universitetit Islamik. Më pas, prej vitit 1390 hixhrij e deri në vitin

1395 hixhrij, mori postin e rektorit. Në të njëjtën kohë ishte edhe ligjërues në xhaminë e të Dërguarit të Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem në Medinë. Mund të themi se nga veçoritë e këtij dijetari të nderuar, Allahu e mëshiroftë, ka qenë se në çdo vend që ka shkuar ka dhënë ligjërata vullnetare për kërkuesit e diturisë dhe nxënësit e saj.

Ai ishte i angazhuar edhe në detyra të tjera. Ai ishte drejtor i Këshillit të Jurisprudencës Islame dhe anëtar në Akademinë e Dijetarëve të Mëdhenj. Në vitin 1395 hixhri, me urdhër të mbretit, emërohet kryetar i Zyrës për Hulumtime Shkencore dhe Fetva në gradën e ministrisë. Në vitin 1414 hixhri mori postin e Kryemyftiut të Arabisë Saudite. Ishte edhe kryetar i këshillit iniciues për formimin e Rabitas, etj.

Shejhu i nderuar, Allahu e mëshiroftë, ishte aktiv gjatë gjithë jetës së tij. Ka qenë gjithmonë ndihmës i organizatave të thirrjes në Islam në tërë botën. Interesohej shumë për formimin dhe mbikëqyrjen e shkollave për mësimin e Kur'anit. Ishte shumë i afërt dhe human me të gjitha shtresat që kishin nevojë. Ishte aktiv në thirrjen islame përmes librave, audio-kasetave dhe pjesëmarrjeve të rregullta në programet e radios, ku kishte emisionin javor "Nurun ala d-derb", në të cilin u

përgjigjej pyetjeve të shumta që vinin nga dëgjuesit.

Mbante ligjërata të rregullta pas namazit të sabahut dhe të akshamit. Dyert e shtëpisë së tij asnjëherë nuk ishin të mbyllura, sofa e tij gjithmonë ka qenë e shtruar për të gjitha shtresat. Ishte shumë i afërt me nxënësit e tij si në universitet edhe jashtë tij. I vizitonte ata në sallat e ligjëratave, ulej me ta, i pyeste për çfarë kishin nevojë. Dyert e bibliotekës së tij kanë qenë të hapura për këdo. Ai sillej me nxënësit e tij si të ishte prindi i tyre.

Këto angazhime të tij u vlerësuan lart nga Mbreti Fejsal, Allahu e mëshiroftë, dhe në vitin 1402 hixhri mori shpërblimin për punën e palodhur në shërbim të fesë islame. Disa nga veprat e tij

1) Mexhmu'ul-fetava, ku janë grumbulluar të gjitha fetvatë e tij dhe artikujt që ka shkruar.

2) Nakdul Kavmij-je el arabij-je (në lëmin e besimit).

3) El-Akidetus-sahiha ve ma judad-duha (në lëmin e besimit).

4) Kejfij-jetu Salatun-Nebij-ji sal-lAllahu alejhi ve sel-lem (në lëmin e fikhut).

5) Ed-da'vetu ilAllah ve ahlakud-duat (në lëmin e etikës, moralit).

Dhe shumë libra të tjerë.

Shembuj nga jeta e tij

Këtë rast e ka treguar kontabilisti i tij, i cili thotë: “Një ditë te shejhu ka ardhur një njeri i cili është ankuar për situatën e tij dhe shejhu ka vendosur që ta ndihmojë me një shumë prej 1000 rialësh. Kur doli ky njeri nga shejhu, shtoi një zero në çekun që kishte dhe kështu shuma që duhet të merrte u bë 10000 rialë. Kur kontabilisti e pa letrën, iu duk shuma e madhe dhe e mori në telefon shejhun. Kur shejhu e kuptoi se çfarë kishte bërë, nuk u hidhërua dhe as që e qortoi. Shumë i qetë ai tha: “Jepja të hollat që

kërkon, sepse ndoshta nevoja e madhe e ka detyruar të gënjejë.” Ky, pra, ishte humaniteti i shejhut dhe zemërgjerësia e tij. Ai kishte mendim të mirë për çdo musliman.

Shejh Muhamed et-Turki, Allahu e ruajttë, tregon: “Ka qenë një njeri në qytetin ed-Delem, i cili kishte armiqësi ndaj shejhut dhe e ofendonte atë çdo herë, ndërsa shejhu gjithmonë kishte heshtur ndaj tij. Pas një kohe ky njeri vdiq, kur shejhu ishte në haxh. Imami i xhamisë refuzoi t'ia falte namazin e xhenazes (pasi ishte në dijeni se ç'kishte folur për shejhun). Kur u kthye shejhu nga haxhi, mori vesh për ngjarjen që kishte ndodhur, u zemërua shumë me imamin e xhamisë dhe e qortoi atë. Më pas shkoi te varri i tij, ia fali namazin e xhenazes dhe u lut për të.

Vdekja e tij

Më 13 maj të vitit 1999, në moshën 90-vjeçare, ndërroi jetë shejhu i nderuar Abdul-Aziz ibën Abdull-llah ibën Baz, Allahu e mëshiroftë. Në varrimin e tij morën pjesë një numër shumë i madh njerëzish, përfshirë edhe udhëheqësinë më të lartë të vendit.

Në fund, e lusim Allahun e Lartësuar me emrat e Tij të bukur dhe me cilësitë e Tij të larta që ta mëshirojë këtë dijetar dhe t'i rrisë gradat e tij në xhenet!

Sabahudin Selimi

Çfarë dini për pozitën e mjekrës në fe?

Lexues të nderuar! Në numrin e parë të kësaj reviste kemi përmendur në editorial se njëri prej qëllimeve tona është të hedhim dritë mbi shumë çështje dhe probleme të errëta e me plot dyshime që lexuesi mund të ketë rreth disa çështjeve të fesë, të cilat janë mbuluar nga pluhuri i mosnjohjes së fesë dhe nga mos ofrimi i mundësisë njerëzve që ta mësojnë atë për shkak të kushteve dhe rrethanave që kanë përjetuar ata. Sigurisht që shumë tema të cilat do t'i trajtojmë në numrat e ardhshëm të kësaj reviste, duke përfshirë edhe numrin që keni në dorë, nuk do të jenë lehtësisht të kuptueshme për të gjitha shtresat e lexuesve dhe kjo është shumë normale, duke qenë se çdo lexues

dallon nga tjetri për sa u përket njohurive që ka rreth çështjeve të fesë. Duke pasur parasysh faktin se kjo fe është plotësuar dhe gjithmonë duhet të shpjegohet duke u ofruar njerëzve të vërtetën, shpresojmë tek Allahu që çdo temë e jona të jetë e dobishme për të gjithë lexuesit pa marrë parasysh njohuritë e tyre rreth fesë dhe shkallën e tyre të besimit. Thashë shkallën e tyre të besimit sepse së pari kjo ndikon në të kuptuarit më të lehtë të fesë dhe se praktikimi i dispozitave dhe ligjeve fetare vjen pas bindjes, duke qenë se kurrë nuk është e mundur të kërkohet nga një person që ta praktikojë një urdhër fetar apo ndonjë ligj nëse nuk është i bindur se ky urdhër apo ligj duhet të veprohet dhe është në interes të tij. Njerëzit apo popullatat e ndryshme u nënshtrohen ligjeve të shumta të bëra nga udhëheqësit e tyre, edhe pse ndoshta një numër i madh i atyre ligjeve nuk u pëlqejnë dhe janë në dëm të tyre. Edhe çështja e mjekrës është një obligim fetar, për mbajtjen e së cilës besimtarit i nevojitet bindja për ta praktikuar atë. Me këtë dua të përgënjeshtroj pretendimet e hedhura në mediumet e shtypura në veçanti dhe në mediumet në përgjithësi, se kinse të rinjtë që kanë filluar të paraqiten te ne me mjekra paguhen me të holla! Kotësinë e këtij pretendimi e kupton çdo analfabet e lëre më një intelektual, pasi me të holla mund të mashtrohet një numër shumë i vogël individësh, edhe pse kjo është shumë

Nga Ibën Omeri transmetohet se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: "Kundërshtoni adhuruesit e idhujve, shkurtoni mustaqet dhe lëshoni mjekrat."

Transmeton Buhariu dhe Muslimi



absurde dhe naive, por është e pamundur të paguhen gjithë këta të rinj që shohim me mjekra, pasi do të nevojitej buxheti i ndonjë shteti të fuqishëm ekonomikisht!

Nuk ka dyshim se kohët e fundit disa nga mediumet botërore mundohen që përmes ekstremistëve, të cilët gjithashtu kanë mjekra, të njollosin të gjithë ata që mbajnë mjekra dhe bashkë me ta edhe imazhin e të gjithë muslimanëve. Ata ia kanë arritur qëllimit deri diku, duke krijuar frikë dhe panik te njerëzit, se kinse çdo njeri me mjekër është ekstremist, ndërkohë që kjo gjë është shumë larg realitetit. Duhet ditur se pasqyrë e fesë janë dy burimet e saj, Kur'ani dhe Sunneti, dhe jo njerëzit, të cilët shkojnë e vijnë dhe secili jep llogari për veprat e veta, qofshin ato të mira apo të këqija. Nëse dikush dëshiron të vlerësojë një ngjarje apo problematikë, atëherë duhet t'u kthehet burimeve të fesë e jo të nxjerrë paragjykime euforike apo të qëllimshme, ose ta vlerësojë fenë në bazë të punëve të liga të njerëzve.

Në vijim do të sjellim argumente nga libri i Allahut dhe fjalët e Pejgamberit tonë, fjalët e të cilit janë shpallje nga Allahu, të cilat tregojnë se mjekra te burrat është një prej shenjave të fesë sonë të dëlirë. Mjekra ka qenë obligim për të gjithë Pejgamberët dhe assesi nuk është diçka e re, e cila nuk ka vend ose pozitë në fenë tonë. Pozita e mjekrës në fe bazohet te fjalët e Allahut dhe të Pejgamberit, mirëpo, siç thamë edhe në fillim, rrethanat në të cilat kanë jetuar njerëzit te ne kanë ndikuar që ata t'i harrojnë shumë simbole të fesë sonë, në mesin e të cilëve është edhe mbajtja e mjekrës.

Në vijim po ju lëmë me argumentet që tregojnë pozitën e mjekrës në fe.

1. Përkufizimi i mjekrës: Dijetari i madh dhe filologu i shquar arab Fejruz Abadij, në fjalorin e tij të njohur “El-kamus El-muhit”, thotë: “Mjekër konsiderohen qimet e dy faqeve dhe të nofullës.”

2. Fjalët e Pejgamberit tonë që urdhërojnë për mbajtjen e mjekrës

a) Nga Ibën Omeri transmetohet se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: “Kundërshtoni adhuruesit e idhujve, shkurtoni mustaqet dhe lëshoni mjekrat.” Transmeton Buhariu dhe Muslimi

b) Nga Ebu Hurejra transmetohet se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: “Shkurtoni mustaqet dhe lëshoni mjekrat; (e me këtë) kundërshtoni adhuruesit e zjarrit.” Transmeton Muslimi, Bejhekiu, Ahmedi dhe të tjerët

c) Nga Ebu Umame transmetohet se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: “Shkurtoni mustaqet dhe lëshoni mjekrat; (e me këtë) kundërshtoni ehlu-kitabin (hebrenjtë dhe të krishterët).” Transmeton Muslimi

d) Nga Aishja transmetohet se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: “Dhjetë gjëra janë prej natyrshmërisë (së njeriut): shkurtimi i mustaqeve, lëshimi i mjekrës...” Transmeton Muslimi dhe të tjerët

Siç e shihni, lexues të nderuar, në çdo hadith të Pejgamberit tonë folja për lëshimin e mjekrës ka ardhur në mënyrë urdhërore dhe kur folja është në këtë mënyrë, ajo tregon obligim. Sipas rregullave të sheriatit, çdo folje në mënyrë urdhërore tregon obligim dhe nuk ka mundësi të zbresë nga shkalla e obligimit, me përjashtim të rastit kur ekziston ndonjë argument tjetër që e zbut urdhrin nga obligimi. Por në këtë çështje nuk ka argument që e zbut rekomandimin e Pejgamberit tonë për lëshimin e mjekrës nga obligim në të preferuar ose në të pëlqyer.

3. Argumentet mbi ndalimin e rruajtjes së mjekrës

1- Ndryshimi i asaj që ka krijuar Allahu Allahu i Lartësuar, kur flet për shejtanin në Kur’an, thotë: **“Dhe Allahu e mallkoi atë,**

ndërsa ai tha: “Do të marr nga robërit e Tu një pjesë të përcaktuar prej tyre. Vërtet që unë do t’i ngatërroj dhe sigurisht që do t’u ngjall dëshira të rreme, do t’i urdhëroj t’u presin veshët begative dhe gjithashtu do t’i urdhëroj të ndryshojnë atë që ka krijuar Allahu.” Dhe kushdo që zgjedh shejtanin si mbrojtës e si mik në vend të Allahut, pa dyshim që ai ka pësuar humbje të qartë.” Nisa: 118-119

Ky është një tekst i qartë që tregon se ndryshimi i krijimit të Allahut pa lejen e Tij është nënshtrim ndaj shejtanit të mallkuar dhe mosrespektim i urdhrave të Allahut. Pa dyshim që edhe vetë Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem i ka mallkuar ata që e ndryshojnë krijimin e Allahut për hir të bukurisë. Ai thotë: “Allahu i ka mallkuar ato që bëjnë tatuazh dhe ato që kërkojnë t’u bëhet tatuazh, ato që ndukin vetullat dhe ato që lënë zbrazëtirë mes dy dhëmbëve të parë për shkak të bukurisë, të cilat (me këtë) ndryshojnë krijimin e Allahut.” Transmeton Buhariu dhe Muslimi

Nga ky hadith kuptojmë se çdo gjë që ndryshohet prej krijimit të Allahut për hir të bukurisë hyn nën këtë mallkim. Nuk ka dyshim që rruajtja e mjekrës bëhet për shkak të bukurisë dhe duke qenë kështu, edhe ata që e rruajnë mjekrën hyjnë nën këtë mallkim.

Dijetari Tehanevij në tefsirin e tij “Bejanul-Kur’an” thotë se rruajtja e mjekrës hyn nën këtë shprehje (të Pejgamberit në hadith).

Kurse Dehleviu në librin e tij “Huxhxhetul-lahi el-Baligah” thotë: “Shkurtimi i mjekrës është prej traditës së adhuruesve të zjarrit dhe konsiderohet ndryshim i formës në të cilën Allahu ka krijuar njeriun.”

2-Kundërshtimi i urdhrimit të Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem

Pra, rruajtja e mjekrës është kundërvajtje e

fjalës së Pejgamberit sal-IAllahu alejhi ve sel-lem në disa hadithe që i përmendëm më herët. “lëshoni mjekrat...”. Këto hadithe, siç cituam më herët, janë në mënyrën urdhërore dhe kur folja vjen në urdhërore, atëherë tregon obligim, me përjashtim të rastit kur ka ndonjë tekst apo argument që e largon foljen nga mënyra urdhërore. Në këtë rast nuk kemi diçka të tillë, përkundrazi, kemi argumente apo tekste të tjera të cilat e përforcojnë edhe më shumë urdhrin për lëshimin e mjekrës, të cilat po i japim më poshtë.

3-Rruajtja e mjekrës është përngjasim me jobesimtarët

Më herët, në hadithet e Pejgamberit sal-IAllahu alejhi ve sel-lem u vërtetua urdhi: “Kundërshtoni adhuruesit e idhujve”, “kundërshtoni adhuruesit e zjarrit” dhe “kundërshtoni ehlul-kitabin”.

Dijetarët islamë kanë thënë se kush beson Allahun dhe Pejgamberin e Tij, duhet t’i kundërshtojë jobesimtarët dhe të mos u ngajjë atyre sepse i Dërguari i Allahut në një hadith autentik ka ndaluar përngjasimin me jobesimtarët. Ai thotë: “Kush i përngjan një populli, ai është prej tyre.” Hadithi është autentik, e transmeton Ebu Davudi në Sunenin e tij.

Rruajtja e mjekrës është përngjasim me të tjerët (jobesimtarët).

4-Është përngjasim me gratë

Pa dyshim se kur mashkulli rruan mjekrën e tij, me të cilën Allahu e ka dalluar nga femra, ai me këtë veprim i përngjan më shumë se kujtdo femrës. E, mashkulli i cili i përngjan femrës është i mallkuar nga gjuha e Pejgamberit sal-IAllahu alejhi ve sel-lem, siç transmetohet te Buhariu, Tirmidhiu e të tjerët nga Abdullah Ibën Abbasi.





5-Kundërshtim i fitres (natyrshmërisë)

Esenca e fitres është forma e parë e krijimit, domethënë se esenca është që Allahu mashkullin e ka veçuar me mjekrën.

Dijetari i madh islam, Ibën Ethiri, në librin e tij madhështor “En-Nihajeh fi garibil-hadith” thotë: “El-fitreh do të thotë tradita (sunneti). Kjo do të thotë që mjekra është sunneti i të gjithë Pejgamberëve dhe ne jemi të urdhëruar t’i pasojmë ata.”

Kurse Sujutiu thotë se komentimi më i mirë për fitren është se ajo është një traditë e vjetër që e kanë zgjedhur të gjithë Pejgamberët dhe pjesë e të gjitha ligjeve (të Allahut) dhe se ata kanë qenë të inspiruar në këtë qysh nga natyrshmëria.

6-Kundërshtim i traditës së Pejgamberëve dhe të njerëzve të mirë

Dijetari i madh Shenkiti, në tefsirin e tij “Ad-vaul-bejan”, kur komenton vargun e Kur’anit: “Ai (Haruni) i tha: “O biri i nënës sime! Mos më kap për mjekre dhe as për koke! Në të vërtetë unë kisha frikë se mos thua: “Ti ke shkaktuar ndonjë mosmarrëveshje mes Bijve të Israilit dhe nuk e ke respektuar fjalën time”^[1], thotë se prej këtij vargu kuptojmë se lëshimi i mjekrës është prej traditës së Pejgamberëve dhe se ky varg aludon se lëshimi i mjekrës është prej kërkesave të shariatit. Përveç kësaj, në shumë hadithe dhe athare^[2] është transmetuar se si Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem, po ashtu edhe shokët e tij, kanë pasur mjekër, madje e kanë pasur edhe të madhe, siç është transmetuar në shumë hadithe. Në këto hadithet thuhet se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem e ka pasur mjekrën e madhe dhe të shpeshtë. Gjithashtu thuhet se edhe Aliu, Allahu qoftë i kënaqur me të, e ka pasur mjekrën e madhe, saqë i ka mbuluar gjoksën. E njëjta gjë thuhet

[1] Ibën Hazmi në “Muhala” thotë: “Dijetarët kanë rënë në ujdë se rruajtja e mjekrës është deformim që nuk lejohet.”

[2] Ibën Tejmije në “El-ihitjarat” thotë: “Dhe ndalohet rruajtja e mjekrës.”

edhe për Uthmanin, Allahu qoftë i kënaqur me të, se e ka pasur mjekrën shumë të gjatë dhe të madhe.

4. Fjalët e dijetarëve për rruajtjen e mjekrës

Shumica dërmuese e dijetarëve islamë kanë deklaruar se rruajtja e mjekrës është haram (e ndaluar), kurse disa prej tyre kanë thënë se është mekruh (e urryer),^[3] mirëpo duke përkujtuar se mekruhu për ta ka pasur për qëllim se është haram, siç është përmendur në shumë libra të shkencës së “Usuli-fikhut”, për të cilën do të flasim në veçanti në rubrikën e jurisprudencës.

1. Ibën Hazmi në “Muhal-la” thotë: *“Dijetarët kanë rënë në ujdi se rruajtja e mjekrës është deformim që nuk lejohet.”*

2. Ibën Tejmije në “El-ihthijarat” thotë: *“Dhe ndalohet rruajtja e mjekrës.”*

3. Ibën Abidini, dijetar i madh i drejtimit juridik fetar hanefij, thotë: *“Ndalohet për meshkujt shkurtimi i mjekrës.”* Reddul-Muhtar 2/418

4. El-Adevijju, dijetar i njohur i drejtimit juridik fetar malikij, thotë: *“Është transmetuar nga Imam Maliku se ai e ka urryer rruajtjen e mjekrës, saqë ka thënë se kjo është prej veprave të mexhusëve (adhuruesve të zjarrit).”*

5. Përveç këtyre dijetarëve të mëhershëm, rruajtjen e mjekrës e kanë ndaluar edhe shumë dijetarë bashkëkohorë, si: Abdul-Xhelil Isa, Ali Mahfudhi, AbdulAziz Ibën Bazi, Nasiruddin Albani dhe të tjerë.
Lexues të nderuar dhe shumë të çmuar!

Këto ishin disa nga argumentet dhe faktet të cilat na ndihmojnë të kuptojmë se mjekra ka një pozitë të veçantë në fe. Ekzistenca e porosive të shumta pejgamberike për lëshimin e mjekrës tregon se ajo nuk është diçka e re apo diçka që lëshohet për të holla, përkundrazi, për lëshimin e saj nevojitet bindje dhe është e pamundur ta detyrosh dikë të mbajë mjekër pa qenë i bindur për të. Shpresoj që lexuesi i nderuar do ta kuptojë njëherë e përgjithmonë se lëshimi i mjekrës është prej obligimeve fetare për çdo musliman dhe se rruajtja apo shkurtimi i saj është i ndaluar. Sa herë që do të përballeni me sulmet e mediuemeve, do ta keni të lehtë të kuptoni se kjo bëhet për të sulmuar një simbol prej simboleve të fesë dhe për të shkaktuar hutim te masa e gjerë, pasi dita-ditës njerëzit po e kuptojnë vendin e çmuar të mjekrës në fe. Allahu na e lehtësoftë të gjithëve mësimin e fesë së Tij dhe praktikimin e saj në mënyrë të denjë dhe na forcoftë para cytjeve të dajave nga njerëzit dhe xhinët!

Përshtati: Zejd Haziri

[3] Ibën Abidini, dijetar i madh i drejtimit juridik fetar hanefij, thotë: “Ndalohet për meshkujt shkurtimi i mjekrës.” Reddul-Muhtar 2/418

[4] El-Adevijju, dijetar i njohur i drejtimit juridik fetar malikij, thotë: “Është transmetuar nga Imam Maliku se ai e ka urryer rruajtjen e mjekrës, saqë ka thënë se kjo është prej veprave të mexhusëve (adhuruesve të zjarrit).”